

Grupi Bankar UFT
Informacion Financiar Periodik
30 Shtator 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE

1. Informacion mbi Strukturën, Aktivitetin kryesor dhe Organizimin e Grupit Bankar	1
2. Bilanci kontabël, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Tregues të rentabilitetit.....	9
3. Struktura e Kapitalit Rregullator	14
4. Mjaftueshmëria e Kapitalit	15
5. Informacion i Përgjithshëm për Ekspozimin ndaj Rreziqeve dhe Administrimin e Tyre	20
6. Rreziku i Kredisë	26
7. Rreziku Operacional	30
8. Rreziku i Likuiditetit	30
9. Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (“ESG”)	31
10. Politikat kontabël të Grupit Bankar	31
11. Politikat e Shpërblimit	37

1. Informacion mbi Strukturën, Aktivitetin kryesor dhe Organizimin e Grupit Bankar

1.1 Informacion i përgjithshëm mbi Grupin Bankar

Unioni Financiar Tiranë Sha (“UFT” ose “Kompania Mëmë”) është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, me NUIS J62424002G, regjistruar në bazë të vendimit të Gjykatës Tiranë No. 9406, datë 6 Mars 1995.

UFT është një institucion financiar që ushtron aktivitetin në Shqipëri. Sic prezantohet me poshte, UFT ka filiale jo vetëm brenda territorit të Shqipërisë, por dhe jashtë saj. Autoriteti mbikëqyrës i kësaj veprimtarie është Banka e Shqipërisë dhe aktivitetin zhvillohet në përputhje me të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës i saj. Që prej vitit **1995**, UFT është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC, duke ofruar shërbime të trasfertave të parave, ndërmjetësimin e arkëtimit dhe pagesave të ndryshme, atë të këmbimit valutor, atë të agjentit apo këshillimit financiar, të konsulencës në fushën e biznesit dhe të administrimit, të emetimit të parasë elektronike (*e-money*). Ai administron dhe kontrollon transfertat e parave të procesuara nëpërmjet Western Union në Shqipëri. Selia e UFT-së është në Rrugën “Ismail Qemali”, Numri 32, Kati 3 Tiranë.

Kapitali i UFT-së është 60 Milionë Lekë.

Aksionarët e tij kanë këtë përqindje investimi në të:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Edmond Leka	35%	35%
Niko Leka	35%	35%
Varuzhan Piranjani	10%	10%
Gjergji Misha*	10%	10%
Eduard Shima*	10%	10%

*) aksionarë pa të drejtë vote


Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i UTF-së është Z. Elton Çollaku.

Këshilli Administrimit:

Edmond Leka	Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anëtar
Niko Leka	Anëtar

UFT ka pjesëmarrje influencuese në subjekte që veprojnë në sektorin bankar dhe jobankar. Ai ka Filiale jo vetëm në Shqipëri, por dhe jashtë saj.

Struktura e Grupit Bankar UFT ("Grupi" ose "Grupi Bankar") në datën e raportimit paraqitet grafikisht më poshtë:



Shënim: Union Bank sha., si institucioni mbizotërues i Grupit, është përgjegjës në bazë të rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, të publikojë informacionin financiar periodik të Grupit.

▪ **Unioni Financiar Prishtinë Shpk (“UFP”)**

UFP është një kompani me përgjegjësi të kufizuar që operon në Kosovë. NUIS i tij është NRB80073291. Ai është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Kosovë dhe ushtron aktivitetin që nga 1 janari 2004. UFP është një institucion financiar që ushtron aktivitetin e transfertave të parave dhe është nën mbikëqyrjen e Bankës Qendrore të Kosovës. Selia e UFP është në Rr. Perandori Justinian IE, Qyteza Pejton, Prishtinë, Kosovë.

Kapitali i UFP-se është 1 Milion Eur.

Aksionarët e tij kanë këtë përqindje investimi në të, si paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Unioni Financiar Tiranë	80%	80%
Bukurosh Stafa	15%	15%
Genc Turku	5%	5%

Administrator i UFP-së është zj. Eda Shaqiri.

▪ **Unija Finansiska Skopje Doo (“UFS”)**

UFS është një kompani me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut me vendim të Gjykatës së Shkupit Nr.5710/03, datë 16 janar 2004. NUIS i tij është NIT4030004498497 dhe është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Maqedoninë e Veriut. Ai ushtron aktivitetin e transfertave të parave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe autoriteti mbikëqyrës i kësaj veprimtarie është Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut. Selia e UFS është në Rr. Goce Dellcev, Shkup, Maqedoni e Veriut.

Aksionarët e tij kanë këtë përqindje investimi në të, si paraqitur në tabelën e mëposhtme:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Unioni Financiar Tiranë sha	75.04%	75.04%
Merita Marku	3.65%	3.65%
Leka Marku	3.65%	3.65%
Nesa Marku	3.65%	3.65%
Illir Mehmeti	10.00%	10.00%
Ylli Marku	4.00%	4.00%

Drejtori Ekzekutiv i UFS-së është z. Ylli Marku.

Union of Financial Corners (“UFC”)

UFC është një institucion financiar i themeluar në 1 maj 2005 në Gjenevë, Zvicër dhe ka NUIS CHE112 349585. Ai është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Zvicër dhe ofron shërbimin e transfertave të parasë. Autoriteti mbikëqyrës është ARIF. Selia e UFC është në Gjenevë, Zvicër.

Kapitali i UFC është 300 Mijë Chf.

Aksionarët e tij kanë këtë përqindje investimi në të:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Unioni Financiar Tiranë sha	51.0%	51.0%
Andi Gjonej	29.0%	29.0%
Kristian Leka	20.0%	20.0%

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i UFC-së është Z. Andi Gjonej.

▪ **Paylink Sha ("Paylink")**

Paylink është një kompani financiare e licensuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer shërbimet e procesimit të kartave si dhe shërbimeve të tjera lidhur me to. NUIS i tij është L22112003M dhe ka filluar aktivitetin në Shtator 2012.

Selia e Paylink sha është në Autostradën Tiranë-Durrës, km 8, Tiranë.

Kapitali i Paylink është 721,467 Mijë Lekë .

UFT zotëron 100% të aksioneve në kapitalin e Paylink sha, dhe gjatë vitit 2025 nuk ka patur ndryshime në pjesëmarrje.

Këshilli Drejtues:

Alban Burazeri	Kryetar
Edmond Leka	Anëtar
Irena Rushaj	Anëtar
Ardiana Kastrati	Anëtar
Eneida Thomaj	Anëtar dhe CEO

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Paylink është Znj. Eneida Thomaj.

▪ **Auto City Sha ("Auto city")**

Investimi në Auto City është bërë në 26 Dhjetor 2012. Auto City është një kompani që nuk operon në sektorin financiar dhe ka NUIS K81918006B. Selia e Auto City është në autostradën Tiranë-Durrës, km 6, Tiranë. Kjo kompani ka objekt aktiviteti: Eksportim, importim, ekspozim , promovimin dhe tregëtimin e artikuljeve dhe mallrave të cdo lloji në mënyrë të vecantë të automjeteve, kryerjen e shërbimeve të cdo lloji vecanërisht të atyre që lidhen me promovimin e artikuljeve e mallrave të cdo lloji vecanërisht të automjeteve përfshirë këtu organizimin dhe menaxhimin e panaiereve ekspozitave apo aktivitete të tjera të ngjashme promovuese, publikimin dhe reklamimin me qëllim promovimin e mallrave, apo shërbimeve të lidhura me aktivitetin etj.

UFT zotëron 100% të aksioneve në kapitalin e Auto City, i cili është 1,566,316 Mijë Lekë.

Këshilli Drejtues

Ardi Afezulli	Anëtar
Elton Çollaku	Anëtar
Varuzhan Piranjani	Anëtar

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv është Z. Genti Joca.

▪ **Union Net Kroaci ("UUK")**

UUK është një institucion financiar i themeluar në 10 Mars 2016 në Zagreb, Kroaci dhe ka NUIS HR74536886827. UUK është përfaqësues kontraktual i Western Union Financial Services INC në Kroaci dhe ofron shërbimin e transfertave të parasë.

UFT zotëron 100% të kapitalit të UUK dhe ky kapital është 1,700 Mijë Kuna (221,680 Eur kosto historike)

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i UUK-së është Z. Krunoslav Valentinc.

▪ **Union Bank Sha**

Union Bank Sha ("Banka") është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 9 Janar 2006 bazuar në Vendimin nr. 101, datë 28 Dhjetor 2005 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë. Banka operon në përputhje me Ligjin nr. 8269 datë 23 dhjetor 1997 "Për Bankën e Shqipërisë", Ligjin nr.9662 datë 18 dhjetor 006 si dhe në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret e aprovuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Autoriteti mbikëqyrës dhe rregullator i saj është Banka e Shqipërisë, por ajo vepron edhe në bazë të rregullave të nxjerra nga autoritete të tjera përkatëse. Ajo ofron shërbime bankare për individë dhe kompani në Republikën e Shqipërisë. Banka është regjistruar si person juridik me numër regjistrimi 33563 datë 26 Maj 2005, datë në të cilën filloi aktivitetin e saj tregtar. Selia e Bankës është në Bulevardin Zogu I, Tiranë.

Kapitali i nënshkruar i Bankës konsiston në 2,097,143 aksione (31 Dhjetor 2024: 2,097,143 aksione) me vlerë nominale 14.77 Euro (31 Dhjetor 2024: 14.77 Euro) secili.

Struktura e kapitalit të nënshkruar e Bankës paraqitet si më poshtë:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Unioni Financiar Tirane Sh.p.k (UFT)	96.46%	96.46%
Edmond Leka	1.77%	1.77%
Niko Leka	1.77%	1.77%

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës është Znj. Flutura Veipi, e cila nuk ka pozicione drejtuese në kompani të tjera.

Drejtuesit dhe administrimi i Bankës më 30 Shtator 2025:

Drejtoria Ekzekutive:

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm dhe Kryetar dhe Përgjegjës për Operacionet e Biznesit
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar dhe Përgjegjës për Operacionet Back office
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar dhe Përgjegjës për Menaxhimin e Rrezikut dhe Financën
Alban Burazeri	Drejtor i Zyrës së Transformimit dhe Anëtar dhe Përgjegjës për Inovacionin, Biznesin dhe Operacionet e IT-së, Aktivitetet që lidhen me Transformimin

Drejtorë të tjerë Divizionesh:

Enkeleda Hasho	Drejtor i Divizionit të Klientëve Biznes
Gent Drita	Drejtor i Divizionit të Kredisë
Irena Rushaj	Drejtor i Divizionit të Teknologjisë së Informacionit

Këshilli Drejtues:

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anëtar
Henry Russell	Anëtar
Gazmend Kadriu	Anëtar
Teuta Baleta	Anëtar
Flutura Veipi	Anëtar edhe CEO
Kreshnik Dibra	Anëtar
Mërgim Cahani	Anëtar

Komiteti i Kontrollit:

Teuta Baleta	Kryetar
Sonila Bicaku	Anëtar
Varuzhan Piranjani	Anëtar shok
Kreshnik Dibra	Anëtar

Përveç Komitetit të Kontrollit (i përhershëm), Këshilli Drejtues, me qëllim realizimin sa më të plotë të përgjegjësiave të tij ka themeluar edhe Komitetin e Strategjisë (i përhershëm), Komitetin e Rrezikut (i përhershëm) dhe Komitetin e Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore (i përhershëm). Detajet e përbërjes së tyre janë publikuar në raportin e Bankës në faqen zyrtare të saj me *link*: <https://www.unionbank.al/raporte-periodike/>.

Nga ana e saj, Drejtoria Ekzekutive e Bankës, ka krijuar komitetet e mëposhtme, përbërja dhe përgjegjësitë e të cilëve janë publikuar në Raportin Periodik (me frekuencë tremujore) të Bankës në faqen zyrtare të saj me *link*: <https://www.unionbank.al/raporte-periodike/>

- 1) Komiteti i Administrimit të Aktiv-Pasiveve (“KAAP”)
- 2) Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë (“KMRK”)
- 3) Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera (“KRO”)
- 4) Komiteti i Menaxhimit të Rrjetit
- 5) Komitetit i Teknologjisë së Informacionit (“KTI”)
- 6) Komiteti i Administrimit të Kolateraleve në Pronësi të Bankës
- 7) Komiteti i Përputhshmërisë
- 8) Komiteti i Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës
- 9) Komiteti i Kredisë
- 10) Komiteti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- 11) Komiteti i Menaxhimit të Produktit
- 12) Komiteti i Sigurisë në Punë
- 13) Komiteti i Rekuperimit dhe Menaxhimit të Vonesave
- 14) Komiteti i Prokurimeve
- 15) Komiteti Drejtues i Projekteve

▪ **Landeslease sha**

Banka, në 22 Dhjetor 2014, bleu 100% të aksioneve të Landeslease sha (“Filiali i Bankës”), një shoqëri shqiptare e cila ushtron aktivitetin e qirasë financiare, e regjistruar si një shoqëri aksionare me vendim të gjykatës nr.33307 dhe NUIS K51629002M. Landeslease sha filloi të operonte në 5 Prill 2005. Ai ushtron aktivitetin në Shqipëri dhe është nën mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë. Gjatë vitit 2023, pas marrjes së vendimeve të strukturave respektive të brendshme si dhe me miratimin e Bankës së Shqipërisë, Unioni Financiar Tiranë Sh.p.k iu shtua strukturës aksionare të Filialit të Bankës nëpërmjet blerjes së aksioneve të reja të emetuara. Pas kësaj, Banka zotëron 81% të aksioneve të Filialit.

Selia e Landeslease sha është në Tiranë, Rruga “Ismail Qemali”.

Investimi në Filialin e Bankës në fund të Shtator 2025 është në shumën prej 460,671 Mijë Lekë.

Këshilli Drejtues:

Arten Zikaj	Kryetar
Enkeleda Hasho	Anëtar
Elton Collaku	Anëtar
Rezart Ferzaj	Anëtar dhe CEO

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Landeslease është Z. Rezart Ferzaj.

1.2 Informacion mbi kodin e etikës së Grupit Bankar

Çdo institucion i Grupit ka një Kod Etik, i cili adreson çështjet e përputhshmërisë me kërkesat ligjore, përgjegjësitë e punonjësve në lidhje me konfliktet e interesit, ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit, veprimet me palët e lidhura, etj. Më poshtë janë trajtuar shkurtimisht një pjesë e tyre:

1. Konflikti i Interesave

Është politika e institucioneve të Grupit që punonjësit të kryejnë detyrat në mënyrë të tillë, me etikë dhe integritet, që të mos ekzistojë konflikt interesi, real apo i nënkuptuar. Situatë konflikti interesi nënkuptohet situata e ndikuar nga faktorë objektivë (si p.sh. lidhje farefisnore/biznesi) që mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave të punonjësit kundër interesave të institucionit të Grupit.

2. Informacioni Konfidencial

Të gjitha dokumentet dhe informacionet e Grupit janë konfidenciale dhe nuk mund të kopjohen ose nxirren pa autorizim nga menaxhimi. Informacioni konfidencial përfshin të dhënat për personelin dhe pagat, informacionin për klientët, dhe çdo informacion tjetër për mënyrën se si operon Grupi.

Abuzimi ose keqpërdorimi i informacionit konfidencial do të rezultojë në masa të rrepta disiplinore, deri në pushim të menjëhershëm nga puna dhe ndjekje ligjore.

3. Punësimi jashtë institucioneve të Grupit

Grupi nuk inkurajon punësimin jashtë tij të një punonjësi me kohë të plotë, sidomos punësimin tek një konkurrent, furnitor apo klient i Grupit. Në të gjitha rastet, punësimi jashtë Grupit kërkon aprovim paraprak nga menaxhimi. Vetëpunësimi në ndonjë aktivitet që i bën konkurrencë Grupit, është i ndaluar.

4. Dhuratat

Punonjësit dhe familjarët e tyre nuk duhet të kërkojnë apo pranojnë përfitime personale nga një klient, shitës, individ ose organizatë që kërkon të bëjë biznes me institucionet e Grupit, përveç dhuratave të zakonshme, me vlerë qartësisht modeste dhe që shpërndahen masivisht për Vit të Ri apo raste të ngjashme.

5. Ryshfetet

Gjatë kryerjes së detyrave në Grup, nuk lejohet të paguhet ose të pranohen ryshfete ose shpërblime të tilla të ngjashme për apo nga ndonjë individ apo organizatë. Është politikë e Grupit të zbatojë rregullat kundër mitmarrjes.

6. Abuzimi me Drogat dhe Alkoolin

Politika e Grupit është që të punësojë persona që nuk përdorin drogë apo alkool dhe që nuk manifestojnë efekte të përdorimit të tyre gjatë orarit të punës. Çdo punonjës që shkel këtë politikë është subjekt i masave disiplinore, deri në dhe përfshirë pushimin nga puna, që në shkeljen e parë.

7. Huat e Punonjësve

Marrja hua e një punonjësi të një institucioni të Grupit nga një klient i institucionit përkatës, individ ose biznes, duhet evituar gjithmonë (përveç rastit kur klienti është një institucion i njohur huadhënës).

8. Autorizim mbi llogari të klientëve (në rastin e Bankës)

Pa aprovim specifik të menaxhimit, punonjësit nuk mund të veprojnë si agjentë ose persona të autorizuar në ndonjë llogari të mbajtur në Bankë (përveç për familjarët e tyre).

1.3 Aktivitetet e subjekteve përbërëse të Grupit Bankar

Informacion mbi aktivitetet e Unionit Financiar Tiranë

- Listë e veprimtarive sipas licencës së marrë:
 - a) Emetimi i parasë elektronike;
 - b) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
 - c) Këmbim valutor;
 - d) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e mësipërme;
- Listë e veprimtarive që UFT kryen:
 - a) Emetimi i parasë elektronike;
 - b) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
 - c) Këmbim valutor;
 - d) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e mësipërme;

Informacion mbi aktivitetet e Unioni Financiar Prishtinë

- Listë e veprimtarive sipas licencës së marrë:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- Listë e veprimtarive që UFP kryen:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;

Informacion mbi aktivitetet e Unija Finansiska Skopje Doo

- Listë e veprimtarive sipas licencës së marrë:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- Listë e veprimtarive që UFS kryen:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;

Informacion mbi aktivitetet e Union of Financial Corners

- Listë e veprimtarive sipas licencës së marrë:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- Listë e veprimtarive që UFC kryen:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;

Informacion mbi aktivitetet e Paylink

- Listë e veprimtarive sipas licencës së marrë:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
 - b) Emetimin dhe administrimin e të gjitha instrumenteve të pagesës përfshirë emetimin e parasë elektronike;
 - c) Operator i kleringut ndërbankar;
- Listë e veprimtarive që Paylink kryen:
 - a) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
 - b) Emetimin dhe administrimin e të gjitha instrumenteve të pagesës përfshirë emetimin e parasë elektronike;
 - c) Skemë kombëtare të pagesave me kartë, shërbimet e "Auditimit & PenTest" *);
 - d) Shërbime këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimet e tjera ndihmëse për veprimtaritë e mësipërme *)

*) Veprimtari për të cilat nuk ka nevojë për licencë

Informacion mbi aktivitetet e Autocity

Objekti i aktivitetit: Eksportim, importim, ekspozim, promovimin dhe tregtimin e artikujve dhe mallrave të çdo lloji, në mënyrë të veçantë të automjeteve; kryerjen e shërbimeve të çdo lloji veçanërisht të atyre që lidhen me promovimin e artikujve e mallrave të çdo lloji, veçanërisht të automjeteve; përfshirë këtu organizimin dhe menaxhimin e panairëve, ekspozitave apo aktivitete të tjera të ngjashme promovuese; publikimin dhe reklamimin me qëllim promovimin e mallrave, shërbimeve të lidhura me aktivitetin, etj.

Informacion mbi aktivitetet e Union Bank

Bazuar në licensën nga Banka e Shqipërisë, Union Bank Sh.a. është e licencuar për të kryer veprimtari bankare dhe financiare si më poshtë:

- 1) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore;
- 2) Qiranë financiare;
- 3) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- 4) Ofrimin e garancive;
- 5) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - a. instrumente të tregut të parase (çeqe, dëftesa, çertifikata të depozitave etj.)
 - b. këmbim valutor;
 - c. instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente të vlerësimit të normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen.
 - d. të letrave me vlerë të transferueshme
- 6) Ofrimin e shërbimit të kasave të sigurimit;
- 7) Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çequet e udhëtarit dhe çequet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular), etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike;
- 8) Ndërmjetësim për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari;
- 9) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimet e tjera ndihmëse për veprimtaritë e listuara më sipër;
- 10) Shërbimet e pagesave, të listuara nga pika 1 deri në pikën 8 të Aneksit 1 të ligjit nr.55, datë 30.04.2020 “Për shërbimet e pagesave: si vijon:
 - 10.1 Shërbimet që mundësojnë depozitim të parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
 - 10.2 Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
 - 10.3 Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
 - a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
 - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
 - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike
 - 10.4 Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
 - a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
 - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
 - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit duke përfshirë pagesat periodike.
 - 10.5 Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave,
 - 10.6 Dërgesat e parave,
 - 10.7 Shërbimi i inicimit të pagesës
 - 10.8 Shërbimi i informimit të llogarisë

Bazuar në licencën nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me vendim Bordi nr. 7, date 31.01.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Banka është e licensuar për të kryer veprimtarinë e Shoqërisë komisionere si më poshtë:

1. Shoqëri për ofrimin e shërbimeve të investimit:
 - a. Marrje dhe transmetim i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare;
 - b. Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve;
 - c. Tregtim për llogari të vet; në lidhje me këto instrumenta financiare:
 - i. titujt e transferueshëm;
 - ii. instrumentet e tregut të parasë.
 2. Shoqëri për ofrimin e shërbimit ndihmës: Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, për instrumentat financiare të parashikuara tek shërbimet e investimit.
- Listë e veprimtarive që Banka kryen aktualisht :

Banka ushtron të gjitha veprimtaritë sipas licensës me përjashtim të ofrimit të shërbimit të qirasë financiare, të cilin e ushtron nëpërmjet Filialit të Bankës.

Informacion mbi aktivitetet e Landeslease

- Listë e veprimtarive sipas licensës së marrë:
 - a) Qiradhënie financiare;
 - b) Qiradhënie operacionale.
- Listë e veprimtarive që Landeslease kryen:
 - a) Qiradhënie financiare;
 - b) Qiradhënie operacionale.

2. Bilanci kontabël, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Tregues të rentabilitetit

2.1 Analiza dhe komente përmbledhëse për ecurinë e gjëndjes financiare të Grupit

Bilanci i Aktiveve dhe Pasiveve të Grupit Bankar në 30 Shtator 2025 (seksioni 2.2)

Aktivet Totale të Grupit në fund të Shtator 2025 janë përafërsisht në nivelin **121.3 Miliardë Lekë**, rreth **10.3 Miliardë Lekë** ose 9.24% më e lartë se balanca në fund të vitit 2024. Ndryshimi/rritja vjen kryesisht si rezultat i zgjerimit të veprimtarisë nga ana e Bankës Union e cila përbën mbi 95% të totalit të asetëve të Grupit Bankar.

Aktivet: Ndryshimet e Aktiveve gjatë periudhës janë karakterizuar nga një rritje e konsiderueshme e Portofolit të Huave dhe paradhënieve për klientët neto (Kredia për klientët) me mbi 4.7 Miliardë Lekë ose 9.67%. Portofoli i Letrave me vlerë (në formën e Bonove të thesarit dhe Obligacioneve) pësoi një rritje vjetore me ~1.9 Miliardë Lekë ose 5.26%, me rritje të Bonove te thesarit me 0.3 Miliardë Lekë dhe me një rritje të investimeve në Obligacione me 1.5 Miliardë Lekë, 4.4%.

Huatë për bankat dhe institucionet e tjera financiare kanë pësuar rritje me 0.5 Miliardë Lekë, dhe mbeten në nivelin e ~2.6 Miliardë Lekë. Theksojmë se ka qenë institucioni Union Bank që ka ndikuar në shumicën dërrmuese të ndryshimeve të lartpërmendura, me fokus më shumë tek kreditimi dhe investimet në letra me vlerë.

Mjetet e qëndrueshme mbeten pothuajse në të njëjtat nivele ~1.8 Miliardë Lekë, me një rritje për periudhën me 0.3 Miliardë Lekë; po ashtu rritje tregon dhe zëri Mjete të tjera, ku përfshihen edhe Llogaritë e marrëdhënies dhe Llogaritë pezull, me ~0.5 Miliardë Lekë.

Detyrimet: Në fund të Shtatorit 2025 totali i Detyrimeve ka qënë në nivelin e 105.4 Miliardë Lekë dhe tregojnë për një rritje me 8.9 Miliardë Lekë ose 9.34%. Veprimet me klientët, që zënë edhe peshën më të madhe të detyrimeve, u rritën me 6.4 Miliardë Lekë ose 8.22%. Peshën më të madhe të rritjes në këtë grup e zënë Detyrimet ndaj klientëve për Depozita me afat të cilat u rritën me ~3.9 Miliardë Lekë ose 9.86%. Pas Depozitave me afat rritjen më të madhe e ka zëri Detyrime ndaj klientëve për Llogari rrjedhëse me ~3.0 Miliardë Lekë ose 12.6%, ndërsa Detyrimet ndaj klientëve për Depozita pa afat tregojnë një rënie me ~0.5 Miliardë Lekë ose 3.8%.

Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare janë rritur me rreth 1.5 Miliardë Lekë, ndërsa Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore, në formën e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes, kanë pësuar rritje me 67.9 Milionë Lekë.

Gjatë tremujorit të dytë të 2025 (referoju seksionit 3, b) Banka nënshkroi një kontratë financimi nëpërmjet Borxhit të varur me EFSE. Pas kësaj Borxhi i varur rritet me 0.5 miliardë Lekë dhe është në nivelin e 2.0 Miliardë Lekë. Ky instrument përbën vetëm 10.9% të totalit të Kapitalit të Grupit.

Rritja e Detyrimeve vjen si rezultat i aktivitetit operacional të Banks, në kursin e zakonshëm të biznesit të saj, dhe është tregues pozitiv i rritjes së vazhdueshme të saj.

Kapitali i Aksionarëve tregoi për një rritje vjetore prej rreth 1.3 Miliardë Lekë ose 8.62%, kryesisht nga fitimi i periudhës i kompanive të Grupit dhe ndikuar negativisht nga rivlerësimi i kapitalit të tyre si pasojë e rënies së kursit të këmbimit të Euros. Interesat e pakicës nuk kanë ndryshime në pjesëmarrje.

Të Ardhurat dhe Shpenzimet nga veprimtaritë kryesore (seksioni 2.3)

Fitimi Neto i tremujorit të tretë të vitit 2025 tregon **1.5 Miliardë Lekë**, ose 15.2% më pak se e njëjta periudhë në vitin e mëparshëm.

Të ardhurat neto nga interesi të periudhës mbërrijnë në afro 3.2 Miliardë Lekë, me një rritje prej rreth 118.4 Milionë Lekë ose 3.8% krahasuar me vitin 2024, ku impaktin më të madh e ka interesi i gjeneruar nga portofoli i kredisë dhe veprimet e thesarit dhe ato ndërbankare. Në total Të ardhurat nga interesat u rritën me rreth 207.3 Milionë Lekë ose 5.0%. Po ashtu shpenzimet për interesat ndryshuan kundrejt vitit 2024 duke u rritur me vetëm 88.9 Milionë Lekë ose 8.5% si rezultati i rritjet së lartë të normave të interesit e shoqëruar me rritjet e fondeve kryeshin në segmentin e depozitave me afat.

Të ardhurat neto nga komisionet janë 1.6 Miliardë Lekë. Krahasuar me vitin 2024, tregojnë 114.5 Milionë Lekë ose 6.7% më pak, që vjen nga një kombinim midis rritjes së shpenzimeve për komisione dhe rënies së të ardhurave nga komisionet.

Të ardhurat të tjera nga veprimtaritë bankare janë rreth 45.7 Milionë Lekë më shumë nga të cilat 35.3 Milionë Lekë nga veprimtaritë e qirasë; ndërsa rezultati neto nga veprimet me valutat rezulton me fitim prej 241.8 Milionë Lekë, kryesisht nga efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit në rezervat e UFT.

Në total, të ardhurat operative prej afro 5.2 Miliardë Lekë, janë rreth 0.2 Miliardë Lekë ose 4.2% më shumë se viti 2024, duke shënuar një rritje të kënaqshme.

Nga ana tjetër, totali i shpenzimeve operative ka patur një rritje me ~323.7 Milionë Lekë ose 10.9% krahasuar me vitin 2024. Zërat me ndikim më të madh në këtë grup shpenzimesh janë: Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë të cilat janë rritur me rreth 148.4 Milionë Lekë ose 10.5%; Shpenzimet për personelin të cilat janë ~124.8 Milionë Lekë më shumë; dhe Shpenzimet e amortizimit të mjeteve të qëndrueshme të cilat u rritën me 49.9 Milionë Lekë. Rritja vjen natyrale, në mbështetje të strategjisë për rritje kryesisht të Bankës e ndërlidhur edhe me përmirësimet operationale në drejtim të përmirësimit të shërbimit kundrejt klientelës.

Shpenzimet për fondet rezervë për huatë regjistruan ~0.2 Miliardë Lekë më shumë, ndërsa Shpenzimet për fonde rezervë të tjera tregojnë ~29.2 Milionë Lekë më pak, kjo e fundit kryesisht nga përmirësimet e çmimit të letrave me vlerë të vendosjes.

Kthimi nga Kapitali aksionar (ROE) rezultoi të jetë në nivelin ~13.4% dhe Kthimi nga Aktivitet mesatare (ROA) rezultoi të jetë në nivelin ~1.7% (detajuar në seksionin 2.4 më poshtë).

2.2 Bilanci Kontabël

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024	Ndryshimi	në %
Aktivët				
Arka dhe Banka Qendrore	12,007,396	10,910,163	1,097,233	10.06%
Bono thesari	1,509,056	1,166,641	342,415	29.35%
Hua dhe paradhënie neto për IF	11,835,377	10,546,378	1,288,999	12.22%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	1,817,187	2,084,483	(267,296)	-12.82%
<i>Depozita</i>	6,966,062	6,019,977	946,085	15.72%
<i>Hua</i>	2,604,848	2,114,500	490,348	23.19%
<i>Llogari të tjera</i>	447,751	327,604	120,147	36.67%
<i>minus fondet rezervë për huat</i>	(471)	(186)	(285)	153.23%
Hua dhe paradhënie neto për klientët	53,594,101	48,866,754	4,727,347	9.67%
<i>Hua dhe paradhënie standarde</i>	50,158,878	46,432,731	3,726,147	8.02%
<i>Hua dhe paradhënie në ndjekje</i>	2,165,833	1,611,812	554,021	34.37%
<i>Hua nënstandard</i>	1,071,681	1,109,221	-37,540	-3.38%
<i>Hua të dyshimta</i>	1,410,479	578,117	832,362	143.98%
<i>Hua të humbura</i>	1,237,952	1,319,825	-81,873	-6.20%
<i>minus fondet rezervë për huatë</i>	(2,450,722)	(2,184,952)	(265,770)	12.16%
Letra me vlerë me të ardhura fikse	35,919,812	34,392,454	1,527,358	4.44%
Filiale	2,757,769	2,263,098	494,670	21.86%
Mjete të qëndrueshme, neto	1,861,182	1,571,425	289,757	18.44%
Mjete të tjera, neto	1,829,615	1,334,598	495,017	37.09%
Totali i Aktiveve	121,314,307	111,051,511	10,262,796	9.24%
Detyrimet				
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	9,661,213	9,593,294	67,919	0.71%
Detyrime ndaj bankave dhe IF	6,274,559	4,733,959	1,540,600	32.54%
Veprime me klientët	84,157,675	77,765,360	6,392,315	8.22%
<i>Qeveria shqiptare e admin publike</i>	207,743	359,897	(152,154)	-42.28%
<i>Llogaritë rrjedhëse</i>	27,120,270	24,087,720	3,032,550	12.59%
<i>Depozita pa afat</i>	12,009,474	12,483,189	(473,715)	-3.79%
<i>Depozita me afat</i>	43,894,751	39,954,600	3,940,151	9.86%
<i>Llogari të tjera</i>	925,437	879,954	45,483	5.17%
Fond rezervë statistikore për huat	647,983	577,790	70,193	12.15%
Detyrime të tjera	2,706,918	2,246,182	460,736	20.51%
Borxhi i varur	1,952,136	1,483,929	468,207	31.55%
Totali i Detyrimeve	105,400,484	96,400,514	8,999,970	9.34%
Totali i Kapitalit aksionar	15,913,823	14,650,997	1,262,826	8.62%
Nga të cilat Interesa të pakicës	786,840	718,289	68,551	9.54%
Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit	121,314,307	111,051,511	10,262,796	9.24%
Zërat jashtë bilancit				
Angazhime të dhëna	2,695,243	2,432,000	263,243	10.82%
Garanci të dhëna	659,294	612,723	46,571	7.60%
Garanci të marra*	132,261,028	118,379,898	13,881,130	11.73%
Veprime valutore (të blera - të shitura)	(858)	(824)	(34)	4.15%

* kolaterale të bllokuara për kreditë e dhëna

2.3 Pasqyra e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve

	30 Shtator 2025	30 Shtator 2024	Ndryshimi	në %
Të ardhura nga interesat	4,350,447	4,143,155	207,292	5.0%
<i>Për veprimet e thesarit</i>	284,601	263,300	21,301	8.1%
<i>Nga veprimet me klientët</i>	2,696,517	2,513,448	183,069	7.3%
<i>Nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare</i>	1,291,916	1,299,653	(7,737)	-0.6%
<i>Të tjera</i>	77,413	66,754	10,659	16.0%
Shpenzime për interesa	(1,131,411)	(1,042,516)	(88,895)	8.5%
<i>Për veprimet e thesarit</i>	(125,201)	(86,143)	(39,058)	45.3%
<i>Për veprimet me klientët</i>	(788,999)	(690,252)	(98,747)	14.3%
<i>Për borxhet e varura</i>	(62,027)	(34,813)	(27,214)	78.2%
<i>Për letrat me vlerë dhe veprimtarite e tjera financiare</i>	(155,184)	(231,308)	76,124	-32.9%
Të ardhurat nga interesat, neto	3,219,036	3,100,639	118,397	3.8%
Të ardhura nga komisione	1,735,404	1,807,582	(72,178)	-4.0%
<i>Nga veprimet e thesarit</i>	1,355	1,575	(220)	-14.0%
<i>Nga transaksionet me klientët</i>	1,056,225	1,197,316	(141,091)	-11.8%
<i>Komisione për shërbimet bankare</i>	640,478	561,516	78,962	14.1%
<i>Komisione të tjera</i>	37,346	47,175	(9,829)	-20.8%
Shpenzime për komisione	(137,896)	(95,530)	(42,366)	44.3%
<i>Për veprimet e thesarit</i>	(13,026)	(7,083)	(5,943)	83.9%
<i>Për transaksionet me klientët</i>	(9,490)	(1,031)	(8,459)	820.5%
<i>Komisione për shërbime bankare</i>	(115,216)	(87,301)	(27,915)	32.0%
<i>Komisione të tjera</i>	(164)	(115)	(49)	42.6%
Të ardhura nga komisionet, neto	1,597,508	1,712,052	(114,544)	-6.7%
Fitim/Humbje nga veprimtaritë e qirasë, neto	118,776	83,480	35,296	42.3%
Fitim/Humbje nga veprimtaritë e tjera bankare, neto	46,489	36,135	10,354	28.7%
Fitim/Humbje nga veprimet me valutat, neto	241,868	78,821	163,047	206.9%
Totali i të ardhurave operative	5,223,677	5,011,127	212,550	4.2%
Shpenzime për personelin	(1,427,906)	(1,303,148)	(124,758)	9.6%
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	(3,193)	(2,605)	(588)	22.6%
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(1,556,159)	(1,407,765)	(148,394)	10.5%
Amortizimi i mjeteve të qëndrueshme	(299,999)	(250,071)	(49,928)	20.0%
Totali i shpenzimeve operative	(3,287,257)	(2,963,589)	(323,668)	10.9%
Shpenzime për fonde rezervë për huatë	(355,692)	(193,044)	(162,648)	84.3%
Shpenzime për fonde rezervë të tjera	(2,969)	26,199	(29,168)	-111.3%
Shpenzime neto për provigjone	(358,661)	(166,845)	(191,816)	115.0%
Veprimtaritë e jashtëzakonshme	82,976	55,877	27,099	48.5%
Fitimi para tatimit	1,660,735	1,936,570	(275,835)	-14.2%
Tatimi mbi fitimin	(195,160)	(207,698)	12,538	-6.0%
Fitimi neto për periudhën	1,465,575	1,728,872	(263,297)	-15.2%

Grupi Bankar Unioni Financiar Tiranë

Raportet Financiare Periodike, Shtator 2025

(shifrat në Mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

2.4 Tregues të rentabilitetit të Grupit Bankar¹:

	30 Shtator 2025	30 Qershor 2025	31 Mars 2025	31 Dhjetor 2024	30 Shtator 2024	30 Qershor 2024	31 Mars 2024	31 Dhjetor 2023
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare *100]	1.69%	1.84%	1.91%	1.92%	2.14%	2.11%	2.51%	1.60%
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare	0.10%	0.10%	0.06%	0.10%	0.07%	0.07%	0.03%	0.11%
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë	50.59%	49.21%	47.04%	49.40%	48.18%	48.33%	44.62%	50.14%
4. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROE) [të ardhurat neto/kapitali aksionar mesatar *100]	13.43%	14.42%	14.54%	16.25%	17.94%	17.56%	19.70%	12.82%
5. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë	21.98%	22.09%	21.87%	22.31%	21.19%	21.19%	19.28%	22.02%

Treguesit e përfitueshmërisë së Grupit Bankar mbeten në nivele të mira dhe të qëndrueshme.

Performanca është më e lartë se ajo e vitit 2023, por pak nën nivelin e vitit 2024. Kjo rënie relative lidhet kryesisht me stabilizimin dhe më pas uljen e normave bazë, të cilat kanë ndikuar në uljen e yield-it të aktiveve që gjenerojnë interes. Ndërkohë, kostoja e fondeve ka mbetur pothuajse në të njëjtat nivele, për shkak të konkurrencës së fortë në treg. Paralelisht, niveli i shpenzimeve dhe i investimeve ka vijuar të rritet, ndërsa edhe niveli i provigjoneve është rritur krahasimisht me vitin 2024, duke ushtruar një presion shtesë mbi rezultatet financiare.

¹ Treguesit e mësipërm janë llogaritur sipas kërkesave të rregullores “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, miratuar me vendim Nr.4, datë 01.02.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Ato janë llogaritur mbi pasqyrat financiare të Grupit, dhe aty ku ka nevojë janë shprehur në bazë vjetore.

3. Struktura e Kapitalit Rregullator

Kapitali rregullator i Grupit Bankar në bazë të karakteristikave të tij dhe kushteve të përcaktuara në rregulloren "Për kapitalin rregullator të bankës" dhe në rregulloren "Për mbikëqyrjen e konsoliduar", ndahet në dy kategori:

- a) kapital i nivelit të parë
- b) kapital i nivelit të dytë

a) **Kapitali i nivelit I** llogaritet si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë, duke marrë në konsideratë zbritjet sipas kërkesave rregullatore. Elementet përbërës të tij janë:

- kapitali i paguar, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme, të cilat mbartin të gjitha karakteristikat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Kapitali i paguar përbëhet nga aksione të cilat nuk janë me përparësi dhe nuk ka kufizime mbi to;
- primet e këtyre aksioneve;
- fitimet e pashpërndara, të cilat janë të lira nga çdo detyrim i ardhshëm, përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë të Bankës, vetëm me miratimin e Asamblese së Përgjithshme për pjesën që parashikohet të jetë element përbërës së tij;
- fitimi ushtrimor i fundvitit;
- fitimi ushtrimor i periudhës raportuese, i cili përfshihet vetëm në rast se plotësohen kushtet e përcaktuara në rregullore;
- rezervat, të cilat përfshijnë rezervat ligjore të krijuara me vendim të Asamblesë së Aksionarëve;
- diferencat e rivlerësimit. Kapitali i Grupit që është në valutë të huaj, vlerësohet në Lekë me kursin në periudhën raportuese, por në bilanc mbahet me vlerën fillestare (koston historike të tij), diferencat e lindura nga ky trajtim, përbëjnë pikërisht diferencat e rivlerësimit;
- interesa të pakicës, të cilat përfaqësojnë shumën (madhësinë) e kapitalit bazë të nivelit të parë të një anëtari të Grupit Bankar, që i atribuohet personave fizike apo juridike, të cilën nuk janë objekt i konsolidimit të Grupit Bankar.

Si zë zbritës i kapitalit bazë të nivelit të parë janë:

- humbjet e periudhës raportuese;
- aktivet e patrupëzuara;
- pjesën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta në instrumentet e kapitalit të nivelit të parë në investime të rëndësishme jashtë sektorit financiar;
- pjesën e shumës së pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta në instrumentet e kapitalit të nivelit të parë në subjekte financiare, ku Grupi ka investime të rëndësishme, duke konsideruar si pjesë të zbritshme:
 - a) atë që tejkalon kufirin prej 10% të kapitalit bazë të nivelit të parë, llogaritur ky para këtyre zbritjeve dhe b) pjesën e mbetur të investimeve të marra së bashku, që tejkalon 17.65% të kapitalit bazë të nivelit të parë pas zbitjeve.

b) **Kapitali i nivelit II** përbëhet nga Borxh i varur i emtuar nga Banka Union, i cili plotëson kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë.

Borxhi i Varur i Bankës është në formën e Obligacioneve dhe është emtuar si më poshtë:

- në vitin 2020, 2 Milionë Euro me afat gjashtëvjeçar dhe normë kuponi fiks 3.25% në vit;
- në vitin 2021, 2 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 3.30% në vit;
- në vitin 2022, 3 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 3.50% në vit;
- në vitin 2023, 3.5 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 4.85% në vit;
- në vitin 2024, 5 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 5% në vit.

Në qershor 2025, Banka nënshkroi një marrëveshje financimi me EFSE, e cila do të përdoret si instrument kapitali i kualifikueshëm për Kapital të Nivelit II. Ky financim synon të rrisë kapacitetin huadhënës të Bankës dhe të forcojë mbështetjen e saj me kapital. Shuma e disbusuar brenda periudhës raportuese, nën këtë linjë është 5 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi variabël Euribor 6M+4% në vit. Në muajin Shtator 2025, pas miratimit nga Banka e Shqipërisë, ky borxh i varur u përfshi në kapitalin rregullator të Bankës.

Në fund të periudhës ky instrument është afro 2.0 Miliardë Lekë, ndërsa 1.6 Miliardë Lekë është shuma që përfshihet në Kapitalin rregullator sipas kritereve të përlllogaritjes të përcaktuara në rregullore.

Kapitali rregullator i Grupit për Shtator 2025 dhe Dhjetor 2024 është si më poshtë:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Kapitali Rregullator	14,710,498	14,284,808
Kapitali i Nivelit të Parë	13,101,295	13,042,267
Kapitali Bazë i Nivelit të Parë	13,101,295	13,042,267
Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit I (KBN1)	(1,596,951)	(1,079,860)
Kapitali i paguar	60,000	60,000
Primet e aksioneve	-	-
(-) Instrumenta të veta të Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë	(1,656,951)	(1,139,860)
Fitimet e pashpërndara	6,525,165	6,383,149
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	5,761,849	4,298,558
Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	763,315	2,084,591
Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	8,247,565	9,030,762
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)		
Diferenca rivlerësimi kreditore	(408,006)	(1,541,203)
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	(453,317)	(468,870)
Interesat e pakicës	786,840	718,289
Kapitali Shtesë i Nivelit të Parë	-	-
Kapitali i Nivelit të Dytë	1,609,202	1,242,542
Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur	1,609,202	1,242,542

Kapitali bazë i nivelit të parë duhet të jetë në çdo kohë më i madh se niveli i kapitalit minimal të kërkuar.

4. Mjaftueshmëria e Kapitalit

4.1 Llogaritja e mjaftueshmërisë së kapitalit

Kapitali rregullator duhet në çdo kohë të mbulojë kërkesën për kapital të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të kredisë, të mbulimit të rrezikut të tregut dhe të mbulimit të rrezikut operacional.

Mjaftueshmëria e kapitalit llogaritet si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, shprehur kjo në përqindje, në zbatim të plotë të rregulloreve në fuqi.

Mbështetur në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", Nr. 48, datë 31.07.2013 dhe në rregulloren "Për Mbikëqyrjen e Konsoliduar", Nr.4, datë 01.02.2017, Grupi përlllogarit raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit si:

Në Mijë Lekë	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
1. Kapitali rregullator	14,710,498	14,284,808
2. Kapitali i nivelit të parë	13,101,295	13,042,267
3. Kapitali bazë i nivelit të parë	13,101,295	13,042,267
4. Totali i ekspozimeve të ponderuara me rrezik	69,925,326	63,326,943
5. Kapitali bazë i nivelit të parë/ Ekspozimet e ponderuara në rrezik $\geq 6.75\%$	18.74%	20.60%
6. Kapitali i nivelit të parë/ Ekspozimet e ponderuara në rrezik $\geq 9\%$	18.74%	20.60%
7. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit $\geq 12\%$	21.04%	22.56%

Ekspozimet e ponderuara me rrezikun llogariten si shumë e elementeve të mëposhtëm:

- zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuar me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kundërpatisë, të llogaritura sipas metodës standarde të rregullores së Mjaftueshmërisë së Kapitalit.

- b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të rregullores së Mjaftueshmërisë së Kapitalit, të shumëzuara me 12.5;
- c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas metodës së treguesit të thjeshtë, të përcaktuar në rregulloren e Mjaftueshmërisë së Kapitalit, të shumëzuara me 12.5.

Më poshtë po japim shumat për secilin komponent, konkluduar në bazë të aplikimit të kërkesave rregullatore për mënyrën e përlllogaritjes së tyre:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	58,861,340	52,633,515
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	370,558	-
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	10,693,428	10,693,428
Totali i ekspozimeve të ponderuar me rrezik	69,925,326	63,326,943

Banka llogarit dhe përmbush edhe kërkesat e kapitalit sipas udhëzimit “Për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit” (“PVBMK”) i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, Banka zbaton kërkesat e rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit”, miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë. Bazuar në kërkesat e kësaj rregulloreje dhe në përputhje me vendimet përkatëse të Guvernatorit, Banka ka siguruar kapital të mjaftueshëm për të përmbushur shtesat makroprudenciale të kapitalit të cilat për tremujorin e tretë 2025 janë në masën +2.75% (2024: +2.5%).

Në zbatim të rregullores PVBMK norma e synuar e mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës për vitin 2025 është niveli 12.95%. Duke parë se treguesi i RMK-se i Grupit Bankar është mjaft më i lartë se ai në nivel Banke (21.04% vs. 17.86%), dhe se kompanitë e tjera të Grupit Bankar (me përjashtim të Filialit të Bankës, Landeslease), pak ose aspak janë të ekspozuara kundrejt rrezikut të kredisë apo rreziqeve financiare, nuk shihet nevoja për kërkesa shtesë, të cilat në çdo rast do të ishin mjaft larg RMK-së së Grupit Bankar.

4.2 Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standarde

Për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuar me rrezik për mbulimin e rrezikut të kredisë, Grupi përdor metodën standarde të rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit". Bazuar në këtë rregullore, të gjitha ekspozimet dhe ekspozimet e mundshme të Grupit Bankar grupohen nëpër klasa të ekspozimeve dhe në varësi të rrezikut të grupeve më të vogla brenda secilës klasë të ekspozimit, këto ekspozime dhe ekspozime të mundshme shpërndahen nëpër klasa rreziku të vlefshme për ponderimet e përcaktuara po në këtë rregullore.

Brenda klasave të ekspozimeve, aty ku është e vlefshme, Grupi përdor vlerësimet e ECAI-ve për të përcaktuar përqindjen e rrezikut të ekspozimeve të ndryshme. ECAI-të, vlerësimet e së cilave Grupi përdor për këtë vlerësim të rrezikut janë Moody's, Fitch dhe S&P.

Në këtë përlllogaritje nuk përfshihen ekspozimet që janë zbritur në kapitalin rregullator të Grupit. Aty ku ekspozimet në investimet në shoqëri në sektorin financiar, nuk kalojnë kufijtë për të cilat aplikohet zbritje në kapitalin rregullator të Grupit, këto ekspozime përfshihen në klasën e ekspozimeve "Ekspozime të kapitalit" dhe ponderohen me një peshë rreziku prej 250%.

4.3 Teknikat e zbutjes së kredisë

Bazuar në rregulloren për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", Grupi përdor si teknika të zbutjes së rrezikut, mbrojtjen e financiar dhe të pafinancuar të kredisë. Në mbrojtjen e financiar, për qëllime të përdorimit të *cash-collateral* si teknikë zbutjeje, Grupi përdor metodën gjithëpërfshirëse për kolateralin financiar. Në bazë të kësaj metode, vlera e rregulluar e kolateralit financiar në fund të Shtator 2025 është 2,811,994 Mijë Lekë (Dhjetor 2024: 2,784,195 Mijë Lekë). Si teknikë të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, Grupi përdor mënyrën e zëvendësimit të ekspozimit ndaj klientëve, me atë ndaj qeverisë qendrore, për shumën e garancive të ofruara nga kjo e fundit për kreditë e garantuara prej saj. Vlera e ekspozimit të zëvendësuar nga garancitë e marra në fund të Shtatorit 2025 është 2,080,280 Mijë Lekë (Dhjetor 2024: 1,857,531 Mijë Lekë).

Tabela më poshtë jep informacion mbi ekspozime të ndryshme sipas peshave të rrezikut, para aplikimit të koeficienteve përkatës për ponderimin e secilës peshë rreziku:

Peshat e rrezikut	Ekspozimi para faktorëve të konvertimit	Vlera e ekspozimit e rregulluar plotësisht (E)	Vlera e ekspozimit pas faktorëve të konvertimit dhe teknikave zbutëse
0%	43,304,143	45,384,423	45,131,594
10%	-	-	-
20%	9,819,654	9,819,654	9,819,654
35%	3,186,118	3,186,118	3,186,118
50%	3,035,879	3,011,617	3,001,206
75%	23,124,031	20,895,667	20,151,466
85%	2,408,042	2,407,683	2,407,683
100%	28,679,388	26,226,750	25,323,487
125%	4,415,842	4,278,529	4,147,570
150%	2,871,631	2,822,294	2,773,001
200%	72,853	72,853	72,853
250%	1,698,105	1,698,105	1,698,105

4.4 Rreziku i kundërpartisë

Rreziku i kredisë së kundërpartisë është rreziku i dështimit të një kundërpartie në një transaksion, para se të bëhet pagesa finale e flukseve të parasë së transaksionit. Ekspozimet e Grupit ndaj kundërpalëve menaxhohen me limite specifike të miratuara për secilën kundërpalë dhe trajtohen në përputhje me kërkesat e kreut III - Rreziku i kredisë, të rregullores "Për raportin e mjaftueshmerisë së kapitalit".

Grupi në përgjithësi ka qasje konservatore duke qenë ndjeshëm nën ekspozimet maksimale të mundshme.

Grupi Bankar Unioni Financiar Tiranë

Raportet Financiare Periodike, Shtator 2025

(shifrat në Mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Tabela më poshtë jep shpërndarjen e ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të Grupit sipas klasave të ekspozimeve dhe peshës së rrezikut, kjo e fundit bazuar në vlerësimin e ECAI-ve apo plotësimin të kushteve rregullatore për secilën klasë ekspozimi.

Klasat e ekspozimeve	Vlerësimet nga:	Peshat e rrezikut											
		0%	10%	20%	35%	50%	75%	85%	100%	125%	150%	200%	250 %
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	Nuk ka	5,323	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	ECAI	37,922,406	-	719,497	-	659,589	-	-	2,422,903	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	ECAI	-	-	229,069	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (ojf)	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	218	-	390	-	-
	ECAI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	Nuk ka	2,074,957	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	ECAI	1,122,942	-	100,756	-	192,726	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	ECAI	482,252	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	Nuk ka	-	-	872,797	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	ECAI	-	-	7,593,080	-	912,656	-	-	158,700	-	50	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	2,316,932	-	1,688,283	-	-
	ECAI	-	-	111,010	-	416,042	-	-	389,042	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	Nuk ka	-	-	-	-	-	19,948,956	-	-	4,019,825	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	Nuk ka	-	-	-	3,186,118	820,193	202,510	2,407,683	589,276	127,744	129,620	-	-
Ekspozime (kredi) me probleme	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	1,004,917	-	91,773	-	-
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	-	-	862,885	72,853	-
Ekspozime të kapitalit		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zëra të tjerë		3,523,713	-	193,446	-	-	-	-	2,925,269	-	-	-	-

4.5 Titullizimi

Jo e aplikueshme (N/A)

4.6 Rreziku i tregut

Grupi ekspozohet ndaj rreziqeve të tregut sa herë që vlera e tregut ose flukset e ardhshme të parasë të një instrumenti financiar luhaten si pasojë e ndryshimeve në çmimet e tregut.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut llogaritet bazuar në kërkesat e kreut VII-Rreziku i tregut, në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". Grupi llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e tregut si shumë të komponenteve të mëposhtëm:

- a) Kërkesa për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm (vetëm nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në rregullore), e cila përfshin:
 - i. Kërkesën për kapital për rreziqet e pozicionit;
 - ii. Kërkesën për kapital për rrezikun e përqendrimit.
- b) Kërkesa për kapital rregullator për të gjitha pozicionet e Grupit (pozicione në librin e tregtueshëm dhe pozicione në librat e bankës), e cila përfshin:
 - i. Kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit;
 - ii. Kërkesën për kapital për rrezikun e pozicioneve në mallra (commodities);
 - iii. Kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes.

Lidhur me pikën a) më sipër, Grupi nuk plotëson kushtet e përcaktuara në rregullore për madhësinë e librit të tregtueshëm dhe si rrjedhim llogarit kërkesën për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm sipas kërkesave të kreut III-Rreziku i kredisë. Lidhur me rrezikun e kursit të këmbimit, Grupi çdo gjashtëmuajor (qershor, dhjetor të çdo viti) llogarit kërkesën për kapital nëse pozicioni valutor neto (total) është më i lartë se 2% e kapitalit të tij rregullator. Në këtë rast, bazuar në përcaktimet e nenit 173, kërkesa për kapital është sa 8% e madhësisë së pozicionit.

Në fund të Shtatorit 2025 pozicioni total neto i hapur valutor është mbi 2% të kapitalit rregullator, dhe për rrjedhojë shuma e llogaritur e kërkesës për kapital për mbulimin e këtij rreziku është 29,645 mijë lekë (Dhjetor 2024: nuk ka patur kërkesë për kapital).

Një tabelë përmbledhëse e ekspozimit dhe kërkesës për kapital për rreziqet e tregut në fund të Shtator 2025 jepet më poshtë:

Rreziqet e tregut (000/Lekë)	Kërkesa për kapital	Ekspozimi i ponderuar me rrezik (kërkesa për kapital*12.5)
Rreziqet e pozicionit	-	-
Rreziku i përqendrimit	-	-
Rreziku i kursit të këmbimit	29,645	370,558
Rreziku i pozicioneve në mallra	-	-
Rreziku i shlyerjes	-	-
Totali	-	-

4.7 Rreziku operacional

Për matjen e kërkesës për kapital për mbulimin e rrezikut operacional, Grupi përdor metodën e treguesit të thjeshtë. Sipas kësaj metode, kjo kërkesë për Shtator 2025 është 855,474 Mijë Lekë (Dhjetor 2024: 855,474 Mijë Lekë). Kjo përlllogaritje bëhet çdo vit, për datën 31 Dhjetor dhe mbahet e njëjtë deri në fund të vitit pasardhës në përlllogaritjen e rradhës (trajtimi në seksionin 7 më poshtë).

4.8 Ekspozimet në instrumente të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës

Jo e aplikueshme (N/A)

5. Informacion i Përgjithshëm për Ekspozimin ndaj Rreziqeve dhe Administrimin e Tyre

5.1 Rreziqet dhe kuadri i administrimit të rreziqeve në UFT dhe institucionet e transferimit të parave pjesë e Grupit Bankar UFT

Veprimtaritë e Unionit Financiar Tiranë e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare dhe këto veprimtari përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe administrimin deri në një masë të caktuar, të rreziqeve ose një kombinimi të tyre. Marrja përsipër e rrezikut është qëndrore për biznesin financiar, ndërkohë që rreziqet operationale janë rrjedhojë e pashmangshme e të qënurit në marrëdhënie biznesi. Rrjedhimisht, objektivi i UFT është arritja e një balance të përshtatshme ndërmjet rrezikut dhe fitimit, si dhe minimizimi i efekteve të mundshme negative në performancën e tij.

Unioni Financiar Tiranë ka nivel pranimi dhe tolerancë të ulët për rrezikun ndaj të cilit është i ekspozuar. Si rezultat, ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të arritur vetëdijen maksimale ndaj rrezikut, si dhe është vendosur një sistem rigoroz i administrimit të rrezikut duke krijuar një kuadër gjithëpërfshirës për administrimin e rrezikut me efikasitet, nëpërmjet identifikimit, matjes, kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të ngjarjeve potenciale që mund të rezultojnë në humbje apo zvogëlim të potencialit të UFT për të gjeneruar rezultate të qëndrueshme.

UFT ka ndërtuar politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e të gjithë rreziqeve me të cilët ballafaqohet duke përfshirë përkufizime të qarta për rreziqet, strukturën përkatëse, instrumentat e përdorur si dhe për filozofinë e vetëvlerësimit të proceseve nga ana e njërive të UFT. Për më tepër, UFT ka krijuar një set treguesish kyç të rrezikut, duke monitoruar në mënyrë aktive performancën e tyre.

Në këtë kontekst, të gjithë proceset e biznesit hartohen për reduktimin e impakteve të mundshme nga rreziqet, duke balancuar kërkesën e përfitueshmërisë së UFT kundrejt rrezikut dhe nivelet e përcaktuara të tolerancës ndaj tij. Çdo punonjës dhe në veçanti “pronarët” e proceseve mbajnë përgjegjësi primare për administrimin e rreziqeve dhe për rrjedhojë mirëmbajtja e kontrolleve të nevojshme dhe e vigjilencës në nivelin e duhur përbën pjesë rutinore të punës së tyre.

5.2 Rreziqet dhe kuadri i administrimit të rreziqeve në Bankën Union

Veprimtaritë e Bankës e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare dhe këto veprimtari përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe administrimin e rreziqeve individuale si dhe të kombinimeve të tyre. Marrja përsipër e rrezikut është pjesë integrale e biznesit, ndërkohë që rreziqet operationale janë një rrjedhojë e pashmangshme e ushtrimit të aktivitetit. Për pasojë, qëllimi i Bankës është arritja e një balance të përshtatshme ndërmjet rrezikut dhe përfitueshmërisë, si dhe minimizimit të efekteve të mundshme negative në performancën e saj financiare dhe operationale.

Për këtë qëllim Banka ka krijuar një kuadër gjithëpërfshirës të menaxhimit të rrezikut, i cili synon administrimin efektiv të rreziqeve përmes proceseve të identifikimit, matjes, kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të ngjarjeve potenciale që mund të rezultojnë në humbje ose në zvogëlimin e potencialit të bankës për të gjeneruar rezultate të qëndrueshme.

Mbrojtja e parë e Bankës kundër humbjeve është e reflektuar në modelin e biznesit të saj dhe në sistemin e kontrolleve të brendshme mbi të cilat ajo operon. Në kuadër të menaxhimit të rrezikut, Banka ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e të gjithë rreziqeve me të cilët ballafaqohet. Në këtë kontekst, të gjithë proceset e biznesit janë dizenuar që të reduktojnë impaktet e mundshme nga rreziqet, duke respektuar “oreksin” e Bankës kundrejt rrezikut dhe nivelet e përcaktuara të tolerancës ndaj tij. Çdo punonjës i Bankës dhe veçanërisht “pronarët” e proceseve, mbajnë përgjegjësi parësore brenda fushës së tyre të veprimtarisë. Për rrjedhojë mirëmbajtja e kontrolleve të duhura dhe e ushtrimit të vigjilencës në nivelin e duhur është pjesë integrale të përgjegjësive të tyre të përditshme.

Përveç sa më sipër, prej kohësh, Banka ka edhe një Departament më vete për administrimin e rrezikut, i cili shërben si një burim parësor për promovimin e kulturës së rrezikut përgjatë të gjithë linjave të biznesit të Bankës. Ky departament paraqet raporte periodike të pavarura në Këshillin Drejtues të Bankës, paralelisht me raportimet drejtuar të menaxhimit Ekzekutiv. Raportet janë gjithëpërfshirëse dhe trajtojnë e analizojnë të gjithë rreziqet e identifikuar. Ky funksion përfaqësohet edhe në komitete të ndryshme që ka krijuar Banka të tilla si Komiteti i Administrimit të Aktiv-Pasivit, Komitetin e Rrezikut Operacional, Komitetin e

Administrimit të Rrezikut të Kredisë si edhe në Komitetin e Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës, duke shprehur opinionet e pavarura në fushat respektive. Ky departament ka një bashkëpunim të shpeshtë dhe të ngushtë me të gjithë njësitë e biznesit dhe nivelin Ekzekutiv dhe zhvillon procese dhe kontrolle efektive të matjes dhe administrimit të rreziqeve, shoqëruar me raportet përkatëse

Duke konsideruar profilin e rrezikut dhe karakteristikat e tij, rreziqet me të cilët përballet Banka janë: Rreziku i Kredisë, Rreziku i Likuiditetit, Rreziku i Normave të Interesit, Rreziku i Kundërpartisë, Rreziku i Kurseve të Këmbimit dhe Rreziku Operacional. Politikat e Bankës lidhur me administrimin e rrezikut janë hartuar në mënyrë që të identifikojnë dhe analizojnë këto rreziqe, të vendosin kontrolle dhe limite të përshtatshme dhe kontrolle të rrezikut, si dhe të monitorojnë rreziqet dhe përjasjen e tyre ndaj limiteve me anë të sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit.

Politikat kryesore të administrimit të rreziqeve

Politika e Kredisë

Politika e Kredisë është dokumenti primar i cili përcakton parimet e administrimit të rrezikut të kredisë, strukturat vendimmarrëse, limitet, etj. Rreziku i Kredisë mund të ulet ose pakësohet me huadhënie të orientuar ndaj fluksit të parave, kolateral të mjaftueshëm si mbrojtje e nivelit të dytë, vendosje e përshtatshme e çmimeve bazuar në rrezikun optimal, strukturim efektiv dhe diversifikim të portofolit, kontrolle të nevojshme e gjithëpërfshirëse të Bankës, etj. Një pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi është edhe monitorimi i vazhdueshëm e i nevojshëm i fondeve rezervë për mbulimin e rrezikut (provigjioneve).

Politika e Administrimit të Aktiveve dhe Pasiveve (AAP)

Politika e AAP është dokumenti kryesor që drejton apo udhëheq aktivitetin e Bankës në lidhje me administrimin e Aktiveve dhe Pasiveve, duke përfshirë gjithë transaksionet me fondet, investimet e burimeve likuide dhe administrimin e rrezikut në pasyrën e bilancit. Paragrafet e mëposhtëm përshkruajnë shkurtimisht fushat kryesore të cilat adresojnë Politikën e AAP:

- **Administrimi i Rrezikut të Likuiditetit**

Banka synon të mbajë një bazë depozituesish të mirë-diversifikuar dhe të lejojë akses të pëlqyeshëm e me opsione të ndryshme për tërheqjen e fondeve duke administruar përqendrimet e mëdha dhe disbalancat strukturore. Përpos kësaj, Banka monitoron çdo faktor të brendshëm apo të jashtëm i cili mund të ketë impakt në kapacitetin që ka Banka për të qëndruar likuide. Politika AAP e Bankës ka zhvilluar modele sasiore, të kombinuara me ato cilësore, për matjen e situatës së likuiditetit të Bankës, në të njëjtën kohë duke respektuar edhe indikatorët e rrezikut të likuiditetit të përcaktuar nga Rregullatori.

- **Administrimi i Rrezikut të Normës së Interesit**

Rreziku i normës së interesit përkufizohet si nivel i ndjeshmërisë së fitimeve të Bankës dhe Kapitalit Aksionar në varësi të luhatjeve të normave të interesit. Rreziku i normës së interesit vjen si rezultat i mënyrës dhe shkallës së ndryshme me të cilën luhatja e normës së interesit ndikon tek aktivet dhe pasivet e Bankës si dhe elementët jashtë bilancit. Politika AAP të Bankës ka ndërtuar limite kontrolli të rrezikut, të cilat monitorohen vazhdimisht. Administrimi i rrezikut të normës së interesit përmbledh analiza «hendek» të ndryshimeve të aktiveve dhe pasiveve në lidhje me intervalet kohore të maturitetit, administrim të interesit marxhinal, vendosje dinamike të çmimeve në lidhje me ndjeshmërinë e aktive/pasiveve ndaj luhatjes së normës së interesit duke treguar kujdes ndaj pritshmërisë së tregjeve dhe gjithmonë duke mbetur brenda limiteve të përcaktuara.

- **Administrimi i Rrezikut të Kursit të Këmbimit**

Rreziku i kursit të këmbimit vjen si rezultat i luhatjeve të kurseve të këmbimit të monedhave të huaja të cilat ndikojnë në ekspozimet në aktivet, detyrimet të Bankës si dhe zërat jashtë bilancit, të cilat janë denominuar në monedha të ndryshme nga Lekë. Politika AAP përfshin rregulla, instrumenta dhe mekanizma kontrolli, përfshi edhe limitet e lejuara të pozicionit të këmbimit valutor, të cilat kanë për qëllim mbulimin dhe mbrojtjen nga rreziku i rivlerësimit të monedhës. Ky rrezik administrohet duke kontrolluar

si këmbimin valutor ashtu edhe limitet e pozicioneve të hapura një-ditore duke qëndruar tërësisht në përputhje me përcaktimet dhe përkufizimet rregullatore.

Politika e Investimeve

Politika e Investimeve dhe derivativet e saj si Politika e Administrimit të Portofoleve të Letrave me Vlerë së bashku me Udhëzimin për Administrimin e Rrezikut të Portofoleve të Letrave me Vlerë përcakton bazat, limitet dhe kriteret primare për të administruar në mënyrë të përgjegjshme investimet financiare të Bankës, në përputhje me strategjinë e saj të biznesit. Kjo politike përcakton kriteret e investimeve të mundshme, limitet si dhe elementët e mbartur, të cilat konsiderohen si rreziqe potenciale nga këto investime, etj.

Politika për Transaksionet me Tituj dhe Shërbimet e ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve.

Kjo politikë synon të sigurojë udhëzime dhe të përcaktojë rregullat ose kërkesat për palët e përfshira në veprimtarinë transaksionare dhe të ndërmjetësimit për llogari të klientit, në mënyrë që të sigurojë nivelin e duhur të mbrojtjes së klientit dhe ekzekutimin sa më mirë të transaksioneve për klientët e Bankës. Qëllimi i politikës është të lehtësojë përdorimin dhe shpërndarjen efikase të likuiditetit në dispozicion, të maksimalizojë fitimin nga ofrimi i shërbimeve investuese me tituj për llogari të klientëve, të përmbushë kërkesat/ nevojat e investimeve të klientëve, të stimulojë aktivitetin e tregtimit të titujve dhe të adresojë kryesisht kërkesat/ nevojat e investimeve që keta kliente kanë. Në këtë kontekst, Politika siguron një kornizë të përgjithshme rregulluese për një qasje të kujdesshme ndaj shërbimeve të investimit dhe atyre ndihmëse të titujve për llogari të klientëve dhe përmbushjes së objektivave të menaxhimit dhe qëllimeve të Bankës.

Politika e Rrezikut të Kundërpartive

Rreziku ndaj ekspozimit të kundërpartive trajtohet në mënyrë shumë të ngjashme si rreziku i kredisë dhe vlerësohet në mënyrë specifike ndaj bankave të tjera si dhe institucioneve financiare, përfshi edhe limitet për kundrapalët e këmbimeve valutore. Në këto raste, kredibiliteti i kundërpartise dhe limitet përkatëse vlerësohen duke u bazuar në kritere dhe metodologji të parapërcaktuara.

Politika e Rrezikut Operacional

Rreziku Operacional (RO) ndodh gjatë kryerjes dhe shpërndarjes të të gjithë produkteve dhe shërbimeve të Bankës e në të njëjtën kohë për shkak të procesimit të të gjitha transaksioneve ditore. Mund të vijë gjithashtu edhe si rezultat i pamjaftueshmërisë apo të dhënave të gabuara nga sistemi i informacionit, dështimit apo mosfunksionimit të teknologjisë, thyerje apo prishje të procedurave të kontrollit, si dhe mashtrimeve apo katastrofave të paparashikuara. Kuadri rregullativ i administrimit të RO të bankës përkufizon në mënyrë shumë të qartë RO për gjithë organizatën dhe një filozofi të menaxhimit dhe proces të vetëvlerësimit e raportimit. Po ashtu, ai përfshin raportim aktiv dhe monitorim në performancë të indikatorëve kyç të rrezikut, analiza të kujdesshme të shkaqeve të humbjeve të mundshme, reagim proaktiv ndaj incidenteve si dhe mirëmbajtje e përditësim të programeve të vazhdimësisë së biznesit.

Politika e Përputhshmërisë

Politika e Përputhshmërisë përfaqëson angazhimin institucional të Bankës për të zhvilluar aktivitetin e saj në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të jashtëm, por edhe standartet e brendshme të Bankës. Ajo përcakton parimet bazë mbi të cilat strukturohet funksionimi i Përputhshmërisë, përfshirë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe raportimin e rreziqeve që mund të lindin nga mosrespektimi i kuadrit rregullator në fuqi.

Kjo politikë përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Njesisë së Përputhshmërisë, e cila këshillon dhe mbikëqyr në lidhje me respektimin e rregulloreve dhe legjisllacionit përkatës, së bashku me funksionet Ligjore, menaxhimin e konfliktit të interesit, cënimin e të drejtave të klientëve në lidhje me transparencën në produktet dhe shërbimet bankare, si dhe mbron reputacionin dhe stabilitetin afatgjatë të Bankës.

Përputhshmëria si një element i sistemit të qeverisjes së brendshme të Bankës është pjesë e sistemit të kontrollit si linjë e dytë e saj. Në këtë kuadër, funksioni i përputhshmërisë në Bankë është i pavarur nga njësiti operacionale dhe vepron në bazë të një kornize të brendshme rregullatore, që shërben për të identifikuar, monitoruar dhe adresuar rreziqet e përputhshmërisë në mënyrë efektive.

Komitetet e administrimit të Rreziqeve

Komiteti i Administrimit të Aktiv-Pasivit (KAAP)

Organizimi dhe mënyra e funksionimit të KAAP mbështetet në rregulloren e brendshme të KAAP dhe në Politikën AAP. Çështjet kryesore që trajtohen nga ky komitet janë: rreziku i normës së interesit dhe ai i likuiditetit, analiza e marzheve, analiza e rezultateve financiare të Bankës, ecuria e depozitave dhe investimeve, analiza e tregjeve dhe konkurrenteve, vlerësimi i mundësive të reja biznesi, etj. Në mënyrë më të detajuar këto janë trajtuar në Politikën AAP të Bankës.

Çështjet kryesore që ndiqen dhe analizohen në KAAP janë:

- Zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare të tregjeve financiare, zhvillimet rregullative, parashikimet për normat e interesit dhe ecurinë e tregjeve, etj;
- Ecuria e fondeve, analiza e normave të interesit, struktura e aktiveve dhe portofoli i investimeve/tregëtimit apo ndonjë mospërputhje në bilancin e Bankës dhe rreziqet që mund të vijnë prej tij;
- Situata aktuale dhe e pritshme e likuiditetit;
- Mjaftueshmëria e Kapitalit, edhe në kuadër të Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (“PVBMK” apo “ICAAP”) dhe Shtesën e Kombinuar Makroprudenciale e Kapitalit (SHKOMAK);
- Ecuria e rezultateve të Bankës (analiza e pasqyrave financiare dhe e treguesve kryesore);
- Strategjia e investimeve në aktive financiare jo-kredi, në përputhje me strategjinë e përgjithshme;
- Strategjia dhe procedurat e veprimtarisë së tregtimit, ndërmjetësimit dhe kujdestarisë së letrave me vlerë (titujve) të transferueshme me klientët e Bankës;
- Përcaktimi i politikave të çmimit dhe të tregtimit të instrumentave financiare (*FX*, Letra me Vlerë etj.) dhe paraqitja e tyre për aprovim në Këshillin Drejtues. Si dhe miratimi i rregulloreve që lidhen me ndërmjetësimin/ tregtimin e instrumentave financiare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre;
- Analiza e ecurisë së veprimtarisë së tregtimit të letrave me vlerë;
- Aprovimin e normave të interesit për produktet e depozitave; blerjeve të letrave me vlerë të huaja; marrëdhënieve të reja për veprimet *FW* të këmbimit;
- Rendimenti dhe kosto e fondeve si dhe *spread*-i dhe *NIM*, në këtë kuadër;
 - a) analiza e sensitivitetit të rrezikut të normës së interesit;
 - b) koordinimin të çmimit të produkteve me qëllim ruajtjen e *margins*.
- Ecuria e *FX* dhe aprovim të limiteve me zyrat e këmbimit;
- Përputhshmëri të veprimtarisë në përputhje me kërkesat/ndryshimet rregullatore;
- Rishikim të Politikave duke reflektuar në to ndryshimet/përmirësimet e nevojshme për të mundësuar vijueshmërinë e biznesit, optimizimin struktural të aktiveve, përfitueshmërinë nga investimet si dhe dhe menaxhimin sa me optimal të rrezikut, etj.

Ky informacion mundëson një monitorim të detajuar dhe të vazhdueshëm të rreziqeve të lartpërmendura, që është edhe baza për vendimmarrjen e KAAP.

Komiteti si rregull mblidhet një herë në muaj. Komiteti merr vendime sa i takon normave të interesit të depozitave apo produkteve të lidhura me to, investimeve në letra me vlerë të huaja, huamarrjen, niveleve të *cash-it*, etj. Në këtë komitet, përtej sa më sipër bëhet edhe shpjegimi i ndonjë përjashtimi të njohur nga kjo politikë, si dhe një plan veprimi dhe afati kohor për ta sjellë Bankën në përputhje me kufijtë e politikës. Politikën nën administrimin e komitetit shkojnë për aprovim në Këshillin Drejtues, si rregull, një herë në vit.

Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera (KRO)

KRO monitoron në mënyrë periodike ngjarjet e humbjeve operationale dhe ka caktuar përgjegjësitë për pakësimin e humbjeve dhe paraqitjen e zgjidhjeve të përshtatshme për mbulimin e rrezikut për aktivitetet që janë subjekt i rrezikut operacional. Ky komitet mblidhet sipas nevojave por si rregull, jo më pak se një herë në tre muaj duke vlerësuar ecurinë e rreziqeve operationale të identifikuar dhe analizën e treguesve

krahasuar me limitet e vendosura nga politika përkatëse. Në këtë Komitet bëhen propozime konkrete për trajnimet që lidhen me njohuritë mbi rreziqet në bankë duke synuar njëherësh edhe në promovimin e kulturës së rrezikut. Diskutimi dhe marrja e vendimeve në lidhje me Vazhdimësinë e Biznesit të Bankës zë një vend të veçantë në mbledhjet periodike të komitetit.

Komiteti merr në shqyrtim rezultatet e vlerësimeve të rrezikut operacional me linjat e biznesit në Bankë me frekuencë vjetore.

Komiteti i Kredisë ("KKr")

Komiteti i kredisë ka përgjegjësinë e vendimmarrjes, detajimit dhe implementimit të procedurave mbi bazë të politikës së aprovuar nga Këshilli Drejtues në fushën e kredidhënies. Siguron që procesi i miratimit të kredive të ndjekë procedurat/ politikat e Bankës në përputhje me kuadrin ligjor rregullativ; krijon një sistem të përshtatshëm për raportimin të Këshilli Drejtues lidhur me aplikimin e politikave dhe limiteve kreditore të vendosura. Anëtarët e Komitetit të Kredisë marrin vendime individuale për kreditë e biznesit dhe të individëve bazuar në raportet e vlerësimit të rrezikut të përgatitur nga Departamentet e Rrezikut nën Divizionin e Kredisë.

Komiteti i Administrimit të Rrezikut të Kredisë ("KARK")

Ky komitet është kryesisht përgjegjës për shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi ekspozimet kreditore, duke siguruar që procesi i huadhënies të jetë në përputhje me tolerancën ndaj rrezikut, politikën e kredisë dhe kërkesat rregullatore. Ky komitet luan rol kyç në zbatimin e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të kredisë sa i përket portofolit kreditor. Komiteti siguron që procedurat e kredisë janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe politikën e kredisë, e cila aprovohet dhe rishikohet nga Këshilli Drejtues si rregull një herë në vit. Ai shqyrton përputhshmërinë me limitet dhe monitoron treguesit dhe limitet e paralajmërimit të hershëm të vendosur nga Banka në fushën e rrezikut të kredisë.

Në këtë komitet shqyrtohen parashikimet makroekonomike dhe zhvillimet financiare në vend të cilat ndikojnë në rrezikun e kredisë si dhe rishikohen periodikisht rezultatet e stress test-eve për cilësinë e portofolit të kredisë së bankës. KMRK ka rol të rëndësishëm në implementimin e politikave të provigjonimit, përfshirë kategorizimin dhe kriteret bazë të provigjonimit të tyre. Rikuperimi dhe fshirja e kredive (përpara miratimit përfundimtar nga Këshilli Drejtues) janë një pjesë e rëndësishme e fushës së punës së këtij komiteti. Komiteti shqyrton në baza vjetore eficientë e shoqërive të sigurimit të operuara nga Banka, shoqëritë e mbledhjes së borxheve, zyrat e ndryshme të vlerësimit të pronave etj.

Komiteti i Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës ("KMKP")

Komiteti fokusohet në tre komponentë të rëndësishëm, pjesë integrale e menaxhimit të rrezikut në Bankë: në lidhje me menaxhimin e kapitalit, në vlerësimet në lidhje me planin e rimëkëmbjes dhe performancën e treguesve të kapitalit të Bankës. Komiteti merr vendime kryesisht të fushës së menaxhimit të rrezikut të kapitalit dhe rishikon ato rreziqe të cilët nuk përfshihen në objektin e komiteteteve të tjera të rrezikut të krijuar në Bankë.

Komiteti i Përputhshmërisë ("KP")

Roli kryesor i Komitetit të Përputhshmërisë është forcimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm duke informuar, këshilluar, ndërmarrë veprime dhe mbështetur Bordin e Drejtorëve dhe drejtuesit e funksioneve kryesore të Bankës në lidhje me rreziqet aktuale të përputhshmërisë me të cilat përballet Banka. Ky komitet shqyrton zhvillimet kryesore rregullatore, ligjet dhe standardet dhe siguron një vlerësim të plotë të rreziqeve të përputhshmërisë, duke e integruar atë në programin vjetor të Përputhshmërisë.

Shënim: Raporti periodik i publikuar i Bankës i trajton më në detaj përgjegjësitë e Komiteteve në kuadër të menaxhimit të rrezikut.

5.3 Rreziqet dhe kuadri i administrimit të rreziqeve në filialin Landeslease Sha,

Veprimtaritë e Landeslease e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare. Për menaxhimin e tyre Landeslease, ka krijuar një kuadër gjithëpërfshirës në mënyrë që të administrojë rrezikun në mënyrë efektive nëpërmjet identifikimit, matjes, kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të ngjarjeve që mund të rezultojnë në humbje apo në zvogëlimin e potencialit të Landeslease për të gjeneruar rezultate të qëndrueshme.

Mbrojtja e parë e Landeslease, në kuadër të parandalimit të humbjeve të mundshme nga rreziqet është e reflektuar në kontrollet dhe modelin e brendshëm sipas të cilit shoqëria operon, duke ndërtuar politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e të gjithë rreziqeve me të cilët ballafaqohet.

Përveç sa më sipër, Landeslease në përbërjen e strukturës organizative ka një Departament më vete për administrimin e rrezikut, i cili shërben si një burim parësor për promovimin e kulturës së rrezikut përgjatë të gjithë linjave të biznesit, dhe jo vetëm atë të rrezikut të financimeve. Ndër detyrat e këtij departamenti janë gjithashtu ndjeka dhe monitorimi i rreziqeve me të cilat përballet institucioni. Departamenti ka një bashkëpunim të shpeshtë dhe të ngushtë me të gjitha njësitë e biznesit dhe nivelin ekzekutiv, si edhe zhvillon procese dhe kontrole efektive të matjes dhe administrimit të rreziqeve, shoqëruar me raportet përkatëse.

Duke konsideruar profilin e rrezikut dhe karakteristikat veprimtarive të cilat zhvillon, rreziqet me të cilët përballet Landeslease janë: Rreziku i Financimit (Qiradhënies), Rreziku i Likuiditetit, Rreziku i Normave të Interesit, Rreziku i Kundërpartisë, Rreziku i Kurseve të Këmbimit dhe Rreziku Operacional. Politikat e Landeslease lidhur me administrimin e rrezikut janë hartuar në mënyrë që të identifikojnë dhe analizojnë këto rreziqe, të vendosin kontrole dhe limite të përshtatshme dhe kontrole të rrezikut, si dhe të monitorojnë rreziqet dhe përjasjen e tyre ndaj limiteve me anë të sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit.

Politikat kryesore të administrimit të rreziqeve

Politika e Financimit

Politika e Financimit, si pjesë e manualit të qirasë financiare, është dokumenti primar i cili përcakton parimet e administrimit të rrezikut të financimeve. Ky rrezik mund të ulet ose pakësohet me financime të orientuara ndaj fluksit të parave, aplikim i raporteve të financimit të mbuluara mbi 100% nga vlera e tregut të aseteve objekt të financimit, garanci apo kolaterale të mjaftueshëm si mbrojtje e nivelit të dytë, vendosje e përshtatshme e çmimeve bazuar në rrezikun optimal, etj. Këtu përfshihen dhe limitet maksimale të lejuara të ekspozimit.

Politika e Administrimit të Aktiveve dhe Pasiveve (AAP)

Politika e AAP është dokumenti kryesor që drejton apo udhëheq aktivitetin e qirasë financiare në lidhje me administrimin e Aktiveve dhe Pasiveve, duke përfshirë të gjitha transaksionet me fondet, investimet e burimeve likuide dhe administrimin e rrezikut në pasqyrën e bilancit.

Politika e Rrezikut Operacional

Rreziku Operacional (RO) ndodh gjatë kryerjes dhe shpërndarjes së gjithë produkteve e në të njëjtën kohë për shkak të procesimit të të gjitha transaksioneve ditore. Mund të vijë gjithashtu edhe si rezultat i pamjaftueshmërisë apo të dhënave të gabuara nga sistemi i informacionit, dështimit apo mosfunksionimit të teknologjisë, thyerjes apo prishjes së procedurave të kontrollit, si dhe mashtrimeve apo katastrofave të paparashikuara.

Në kuadrin rregullator të Landeslease përfshihet edhe menaxhimi i RO, në të cilin përfshihen menaxhimi, procesi i vetëvlerësimit dhe ai i raportimit. Po ashtu, ai përfshin raportim aktiv dhe monitorim në performancë të indikatorëve kyç të rrezikut, analiza të kujdesshme të shkaqeve të humbjeve të mundshme, reagim proaktiv ndaj incidenteve si edhe mirëmbajtje e përditësim të programeve të vazhdimësisë së biznesit.

Komitetet e administrimit të Rreziqeve

Rreziqet lidhur me Administrimin e Aktiv-Pasivit ("AAP")

Rreziqet e menaxhimit të aktiv-pasivitetit, në varësi të fushës trajtohen prej Departamentit të Financës, apo Departamentit të Rrezikut, kjo duke qenë se një *Komiteti i Administrimit të Aktiv-Pasivitetit ("KAAP")* do të ishte i tepërt për aktivitetin e kufizuar të qirasë financiare.

Është për t'u përmendur se edhe Këshilli Drejtues ka një rol të fortë monitorues të rreziqeve kryesore.

Analiza e rreziqeve bëhet mbi bazën e një raportimi të detajuar mujor i cili përmban sa më poshtë:

- Ecurinë e zërave të pasqyrave financiare krahasuar me buxhetin;
- Ecurinë e normave të interesit të aktiveve, të detyrimeve dhe të marzheve;
- Ecurinë e treguesve të përfitueshmërisë, strukturës së bilancit, kostove financiare dhe operacionale, etj.;
- Gjendjen e likuiditetit;
- Ecuria e portofolit të financimeve;
- Raporte të detajuara të përcaktuara nga politikat e aplikueshme (listuar më sipër) si dhe ecurinë e limiteve të vendosura për: Rrezikun e Normave të Interesit, Rrezikun e Likuiditetit, Pozicionin e Hapur Valutor, etj.;

Ky informacion mundëson një monitorim të detajuar dhe të vazhdueshëm të rreziqeve të lartpërmendura, që është edhe baza për vendimmarrjen.

Komiteti i Rrezikut Operacional

Ky komitet përbëhet nga: Drejtori i Departamentit të Operacioneve, Drejtori i Departamentit të Financës dhe Drejtori i Departamentit të Rrezikut. KRO monitoron në mënyrë periodike ngjarjet operacionale dhe ka caktuar përgjegjësitë për pakësimin e humbjeve të mundshme dhe paraqitjen e zgjidhjeve të përshtatshme për mbulimin e rrezikut për aktivitetet që janë subjekt i rrezikut operacional.

Komiteti i Qiradhënies Financiare

Ky komitet përbëhet nga: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Drejtori i Departamentit të Kredisë dhe Drejtori i Departamentit të Financës. Komiteti ka ndër të tjera këto përgjegjësi:

- Miratimin e transaksioneve të qirasë financiare, përfshirë afatet dhe kushtet e financimeve
- Detajimin dhe implementimin e procedurave mbi bazë të rregulloreve dhe procedurave të aprovuara nga Këshilli Drejtues, zbatimin e këtyre procedurave dhe amendimin e tyre mbi bazë të zhvillimeve të mundshme;
- Siguron që procedurat/ praktikat e financimit të jenë në përputhje me kuadrin ligjor rregullativ;
- Krijon një sistem eficient për matjen, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e rrezikut të financimeve;
- Krijon një sistem të përshtatshëm për raportimin te Këshilli Drejtues lidhur me aplikimin e politikave dhe limiteve të ekspozimit ndaj financimeve të vendosura;
- Ndërmerr analiza periodike lidhur me rrezikun e financimeve apo ekspozimet e mëdha, etj.;

Ky komitet mblidhet sipas nevojave por jo më pak se një herë në muaj duke vlerësuar, ndër të tjera, edhe ecurinë e rreziqeve të financimeve të identifikuar, analizën e treguesve të performancës së portofolit si edhe aprovimet e financimeve. Në kuadër të menaxhimit të rrezikut të financimeve, mbi një nivel të caktuar apo për terma përjashtimore, në aprovimin e rasteve kërkohet përfshirja në vendimmarrje e Këshillit Drejtues.

6. Rreziku i Kredisë

6.1 Struktura e administrimit të rrezikut të kredisë

Aktiviteti kredidhënës në institucionet e Grupit përmbushet nga Banka dhe Filiali i saj.

Rreziku i kredisë është rreziku që pala tjetër e një instrumenti financiar të dështojë në ripagimin e detyrimit dhe t'i shkaktojë Grupit humbje. Grupi është subjekt i rrezikut të kredisë nëpërmjet veprimtarisë së tij kredituese, dhe në rastet kur ai vepron si ndërmjetës në emër të klientëve ose palëve të treta kur lëshon garanci, në këtë rast, rreziku i kredise buron nga mundësia që palë të ndryshme të mund të dështojnë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Çdonjëri nga entitetet brenda Grupit menaxhon rrezikun e kredisë bazuar në politikat e aprovuara nga Këshillet Drejtuese respektive. Grupi administron dhe kontrollon rrezikun e kredisë duke përcaktuar kufizimet për sasinë e rrezikut që është e gatshme të pranojë për palët individuale dhe për përqëndrimet gjeografike dhe të industrisë dhe duke monitoruar ekspozimet në lidhje me këto kufizime. Limitet kreditore të lejuara për një klient bazohen kryesisht nga profili individual i rrezikut të tij dhe rankimit të tij kreditor bazuar në kriteret e njohura të kreditimit. Kolateralet e vendosura për një kredi, lehtësi kredituese apo produkte të tjera janë elemente të tjerë që merren në konsideratë përgjatë aprovimit apo rinovimit të limitit kreditor të klientit.

Në bazë të politikave të aprovuara nga Këshillet Mbikëqyres, Komiteti i Kredisë për Bankën dhe Komiteti i Qirasë Financiare për Filialin janë përgjegjes për administrimin e rrezikut kreditor. Përgjegjesitë kryesore të Komiteteve të Kredise së Grupit përfshijnë monitorimin dhe propozimin e ndryshimeve në Politikën Kredituese të Grupit; zhvillimin dhe monitorimin e hierarkisë së autoriteteve aprovuese të deleguara (nën komitetet) dhe limitet e ekspozimeve të rëndësishme dhe kriteret e aplikuar për çdo autoritet. Komiteti i Kredisë gjithashtu vlerëson kriteret për klasifikimin e portofolit të kredise dhe përlogaritjen e zhvleresimit të tij dhe rezultatet përkatëse në përputhje me standartet e aplikuar. Rreziku i kredisë operacionalisht menaxhohet dhe monitorohet nga departamentet e rrezikut të kredisë, pjesë të Divizionit të Kredisë. Është përgjegjësia e tyre që të rishikojnë dhe menaxhojnë rrezikun e kredisë, përfshi edhe rrezikun social dhe atë të ambientit për të gjitha kategoritë e kundrapalëve. Çdo njësi biznesi i është kërkuar që të implementojë politikat dhe procedurat kreditore të Bankës e Filialit të saj, me autoritetet aprovuese kreditore të deleguara nga Divizioni i Kredisë dhe Komiteti i Kredisë, bazuar në Politiken e Kredisë. Çdo njësi biznesi ka një përgjegjës i cili raporton për të gjitha çështjet që lidhen me kredinë tek drejtorët e departamenteve dhe tek Komiteti i Kredisë.

Çdo njësi biznesi është përgjegjëse për cilësinë dhe performancën e portofolit kreditor dhe për monitorimin dhe kontrollin e të gjithë rreziqeve kreditore të portofoleve të tyre, si atyre që janë subjekt i aprovimeve qëndrore ashtu edhe atyre të decentralizuara.

Entitetet brenda Grupit kanë vendosur një proces të rishikimit të cilësisë së kredisë në mënyrë që të sigurojë një identifikim të hershëm të ndryshimeve të mundshme në vlerësimin kreditor të kundërpative, duke përfshirë dhe rishikimin periodik të kolateralëve. Kufizimet ndaj kundërpative janë vendosur nëpërmjet përdorimit të një sistemi për klasifikimin e rrezikut, i cili i vendos çdo kundërpative një nivel rreziku. Procesi i rishikimit të cilësisë së kredisë ka si qëllim të mundësojë entitetet e Grupit të vlerësojnë humbjen e mundshme si rezultat i rrezikut me të cilin është ekspozuar dhe të ndërmarrin veprime korrigjuese.

Banka aplikon dhe monitoron kërkesat e rregullores "Për administrimin e rrezikut të kredisë" lidhur me fshirjen nga bilanci të kredive të humbura. Fshirja nga bilanci diskutohet dhe shqyrtohet në Komitetin e Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë dhe miratimi final bëhet nga Këshilli Drejtues. Si rregull, Banka aplikon fshirje të ekspozimit nga bilanci vetëm për ato ekspozime apo pjesë të tij për të cilat janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hallkat ligjore të rikuperimit të kredisë, pasi që këto janë klasifikuar të humbura prej dy vitesh dhe provigjonuar 100%. Pavarësisht fshirjes së kredive nga bilanci, Banka vlerëson dhe monitoron në mënyrë periodike dosjet e kredive të fshira dhe vazhdon të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e tyre.

Bazuar në politikat e aprovuara nga Këshilli Drejtues, Komiteti i Menaxhimit të Aktiv Pasiveve të Bankës është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të kredisë të lidhur me investimet në Letra me vlerë (Tituj). Përveç kësaj Departamenti i Thesarit, që raporton pranë Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv në Bankë në Bankë dhe Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut që raporton pranë Drejtorit të Divizionit të Financës, janë përgjegjës për monitorimin e rrezikut të kredisë që lidhet me investimet e Bankës.

Për më tepër, kontrole të rregullta të njëjësive të biznesit dhe proceseve të kredisë në Grup ndërmerren nga Kontrolli i Brendshëm.

6.2 Kategorizimi i kredive në kuadër të rrezikut të kredisë

Grupi ka krijuar procedurat përkatëse për administrimin e rrezikut të kredisë, përshtatur kjo me vëllimin, kompleksitetin e veprimtarisë së tij, duke u bazuar në rregulloren nr. 62 "Për Administrimin e rrezikut të

kredisë" dhe rregulloren nr. 2 "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka" të Bankës së Shqipërisë.

Mbështetur në këto rregullore, Grupi klasifikon kreditë në bazë të ditëvonesave në shlyerjen e kredisë dhe gjendjes financiare të kredimarrësit sipas kategorive të mëposhtme:

- a) standarde;
- b) në ndjekje;
- c) nënstandarde;
- d) të dyshimta;
- e) të humbura

Grupi për persona apo grup personash të lidhur me njëri-tjetrin, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bën klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.

6.3 Portofoli kreditor, kreditë me probleme dhe krijimi i fondeve rezervë

Kreditë konsiderohen me probleme kur janë të klasifikuara në një nga tre klasat e fundit të kategorive të mësipërme.

Në varësi të kategorive të mësipërme, Grupi Bankar krijon fonde rezerve për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë. Fondet krijohen në përputhje me rregulloren për "Administrimin e rrezikut të kredisë", duke aplikuar normat e provigjonimit të çdo kategorie në të cilën kredia/klienti bën pjesë, si mbi principalin e mbetur dhe mbi interesin e rrjedhur për këto kredi.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë administrohet gjithashtu pjesërisht nga marrja e kolateraleve dhe garancive. Llojet kryesore të kolateraleve janë:

- Prona hipotekore ose rezidenciale;
- Pengje mbi aktivet dhe inventaret e bizneseve;
- Depozita dhe llogari të vendosura në bankë (kolateral ne mjete monetare);
- Garantë personale për kredinë;
- Skemat e ndarjes së rrezikut kreditor (risk sharing).

Përveç kredive me afat dhe overdrafteve të biznesit që janë siguruar nga llojet e mësipërme të kolateralit, Grupi jep gjithashtu overdrafte në llogaritë e pagës. Nuk merren pengje për këto lloj paradhëniesh për sa kohë që pagesat mujore të pagave kompensojnë pjesën e përdorur të limitit të dhënë. Garancitë financiare dhe letrat në pritje të kredisë janë të kolateralizuara me mjete monetare.

Më poshtë është teprica bruto e kredisë e dhënë klientëve e grupuar sipas tipit të klientit:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Kredi dhënë institucioneve financiare	2,665,611	2,166,502
Kredi dhënë individeve	27,312,868	24,829,791
Kredi dhënë kompanive	28,662,954	26,155,444
Totali	58,641,433	53,151,737

Portofoli i mësipërm i kredisë ka një thyerje sipas maturitetit të mbetur kontraktual të tillë:

30 Shtator 2025							
Produkti	Deri 1						Totali
	muaj	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5 vite	>5 vite	
Kredia	369,921	653,720	269,127	982,993	17,480,347	30,958,967	50,715,075
Overdrafte	717,204	502,601	602,720	1,862,783	1,077,334	-	4,762,641
Karta Krediti	4,654	48	87	394	445,831	-	451,014
Qira financiare	20,779	5,431	27,396	76,282	2,453,818	128,997	2,712,703
Totali	1,112,558	1,161,800	899,330	2,922,451	21,457,330	31,087,964	58,641,433

31 Dhjetor 2024

Produkti	Deri 1 muaj	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5 vite	>5 vite	Totali
Kredia	390,899	552,238	162,533	1,876,172	15,322,780	27,605,069	45,909,692
Overdrafte	397,661	639,408	830,980	1,507,297	869,186	-	4,244,532
Karta Krediti	3,865	-	94	132	393,020	-	397,111
Qira financiare	40,958	10,450	20,984	46,853	2,313,929	167,229	2,600,403
Totali	833,383	1,202,096	1,014,591	3,430,454	18,898,915	27,772,298	53,151,737

Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme të kredive përlogariten çdo muaj. Në fund të Shtatorit 2025 dhe Dhjetorit 2024, këto fonde ishin krijuar për këto kategori të kredive të Grupit:

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Hua standarde	541,938	496,149
Hua në ndjekje	112,600	81,824
Hua nënstandarde	367,113	433,037
Hua të dyshimta	841,151	442,071
Hua të humbura	1,235,082	1,309,846
Totali i provigjoneve për huatë	3,097,884	2,762,927

Më poshtë po japim klasifikimin e portofolit të kredisë sipas një shpërndarje gjeografike:

	30 Shtator 2025		
	Teprica bruto	Provigjone	Kredi me probleme
Tiranë	42,632,904	2,210,203	2,715,154
Durrës	3,964,790	167,216	138,211
Veri	4,454,345	223,201	250,838
Jug	5,377,576	292,424	401,425
Juglindje	2,211,818	204,840	205,339
Totali	58,641,433	3,097,884	3,710,967

	31 Dhjetor 2024		
	Teprica bruto	Provigjone	Kredi me probleme
Tiranë	39,147,030	2,054,207	2,304,552
Durrës	3,440,732	139,760	124,100
Veri	3,948,993	194,604	197,560
Jug	4,552,184	169,377	165,616
Juglindje	2,062,798	204,979	204,568
Totali	53,151,737	2,762,927	2,996,396

Më poshtë po japim ndryshimet në fondet rezervë për humbjet nga kreditë gjatë periudhës:

- Huatë standarde dhe në ndjekje

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Gjendja në fillim të vitit	577,973	537,424
Provigjioni për vitin, neto	81,109	58,520
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(4,544)	(17,971)
Gjendja në fund të vitit/periudhës	654,538	577,973

- Huatë me probleme

	30 Shtator 2025	31 Dhjetor 2024
Gjendja në fillim të vitit	2,184,954	2,059,928

Provigjioni specifik, neto për vitin	278,233	275,323
Hua të fshira gjatë vitit	-	(73,996)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(19,841)	(76,301)
Gjendja në fund të vitit/periudhës	2,443,346	2,184,954

7. Rreziku Operacional

Rreziku Operacional është i pranishëm përgjatë lëvrimit të të gjitha produkteve dhe shërbimeve bankare e financiare dhe mund të shfaqet në transaksionet që procesohen. Ai mund të ndodhë edhe si rezultat i sistemeve të pamjaftueshme, të informacionit të papërshtatshëm, dështimeve të teknologjisë, dëmtimit të kontrolleve të brendshme, mashtremeve apo katastrofave të paparashikueshme.

Në mënyrë që të mbrohet nga rreziku operacional secili institucion i Grupit ka hartuar një kuadër të brendshëm i cili përfshin përkufizime të qarta të rrezikut operacional, strukturën përkatëse dhe instrumentat e përdorur për vlerësimin dhe minimizimin e tij.

Sa i takon Bankës dhe Filialit të saj, ato kanë zhvilluar një set treguesish kyç të rrezikut dhe janë duke monitoruar në mënyrë aktive performancën e tyre. Eventet e rrezikut operacional analizohen dhe monitorohen me kujdes, në kuadër të ekspozimit kundrejt rreziqeve të paparashikuara apo humbjeve potenciale. Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera i secilit institucion ndjek në mënyrë periodike ngjarjet që shkaktojnë humbje operationale dhe kanë përcaktuar përgjegjësitë përkatëse për shmangien e humbjeve si dhe përshtatshmërinë e procedurave, eficientë e kontrolleve dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë.

8. Rreziku i Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që institucionet e Grupit do të mund të ndeshen me vështiresi për të siguruar fonde dhe për të plotësuar detyrimet që burojnë nga instrumentet financiarë, dhe në përgjithësi për të ruajtur vazhdimësinë e linjave thelbësore të biznesit.

Secili institucion i Grupit mban likuiditetin në një shumë, strukturë dhe raporte që e lejojnë atë të përmbushë detyrimet e tij dhe angazhimet e marra sipas afateve kohore, me një kosto të arsyeshme dhe rrezik minimal.

Niveli i likuiditetit mbetet i mjaftueshëm për shlyerjen e obligimeve kontraktuale dhe ushtrimin e aktivitetit të Grupit.

Për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit që vjen nga detyrimet financiare, në radhë të parë Banka mban aktive likuide, duke përfshirë dhe paranë dhe ekuivalentet e saj, për të cilat ka një treg aktiv likuid dhe suportojnë planet për rritje dhe investim të Bankës. Struktura e aktiv-pasiveve është e tillë që plotëson kërkesat për likuiditet. Politikat e KAAP përfshijnë sete raportesh dhe treguesish ditore, javore dhe mujore që përgatiten dhe analizohen. Raporti ditor, "Pozicioni i likuiditetit", kontrollon respektivisht rrjedhjet e parasë me maturim deri në një vit, nën skenarin e zakonshëm të biznesit. Raportet mujore përfshijnë koeficiente, analiza të Hendekut të të drejtave dhe detyrimeve me specifika të veçanta të Bankës dhe të atij të simuluar sipas skenarëve krizë të tregut. Raportet prodhohen për çdo monedhë më vete (Lekë, Usd dhe Eur) si dhe për të gjitha valutat së bashku. Tregues në monitorim të vazhdueshëm të Bankës janë edhe Norma e mbulimit me likuiditet (RML) e Koeficienti i fondeve stabil neto (NSFR).

Si pjesë e një kuadri më të gjerë të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, Banka ka kryer Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Likuiditetit (PVBML) dhe monitoron në mënyrë periodike treguesit bazë të tij (përfshi Planin e Kontigjensës së Fondeve), si dhe ka përfshirë këtë rrezik si një ndër elementët kyç të Planit të Rimëkëmbjes, sipas specifikimeve të rregullores përkatëse. Të dy këto plane janë pjesë e rishikimit vjetor të KMAP dhe aprovohen në nivel Këshilli Drejtues.

Banka mban likuiditetin në një shumë, strukturë dhe raporte që e lejojnë atë të përmbushë detyrimet e saj dhe angazhimet e marra sipas afateve kohore, por edhe të suportojë rritjen e buxhetuar të aktivitetit të Bankës, me një kosto të arsyeshme dhe rrezik brenda oreksit të rrezikut të Bankës. Në vazhdimësi niveli i likuiditeteve në Bankë është përmblimitet e brendshme të përcaktuara në politikat përkatëse.

Landeslease sha, në kaudër të menaxhimit të likuiditetit, përveç ndjekjes së hendekut të likuiditetit ka të siguar edhe linjë overdrafti nga Banka, për të mundësuar menaxhimin afatshkurtër të nevojave për likuiditet.

Aktualisht nuk ka ndonjë marrëveshje brenda Grupit për mbështetje me likuiditet. Grupi mban likuiditetin në një shumë, strukturë dhe raporte që e lejojnë atë të përmbushë detyrimet e saj dhe angazhimet e marra sipas afateve kohore, por edhe të suportojë rritjen e buxhetuar të aktivitetit të tij, me një kosto të arsyeshme dhe rrezik brenda oreksit të rrezikut të Grupit.

9. Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (“ESG”)

ESG përfaqëson mundësitë për të pësuar humbje, kosto shtesë apo mosrealizim të të ardhurave të planifikuara. Faktorët aktualë ose të ardhshëm të ESG-së ndikojnë në performancën financiare, reputacionin e bankës dhe marrëdhëniet e saj me palët e treta, perfshi investitorë, klientë, dhe organet rregullatorë.

Rreziqet që burojnë nga ndryshimet klimatike dhe mjedisin po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Duke qenë kanalizues i flukseve të kapitalit, sistemi bankar ka një rol kyç në tranzicionin drejt një ekonomie më të qëndrueshme. Në këtë kuadër, si ndikimet klimatike, ashtu edhe tranzicioni drejt aktiviteteve të qëndrueshme përbëjnë burim rreziku për Bankën.

Është e rëndësishme të theksohet se kjo fazë zhvillimi nuk është specifike vetëm për bankën tonë, por reflekton një realitet më të gjerë të gjithë sistemit bankar, i cili ndodhet aktualisht në hapat e parë të ndërtimit dhe konsolidimit të kuadrit për menaxhimin e rreziqeve ESG. Banka fillimisht, është fokusuar tek identifikimi i rreziqeve materiale dhe mbi këtë bazë kryhet vlerësimi i ndikimit potencial në modelin e biznesit. Më tej, parashikohet përshtatja e strukturave të brendshme për të menaxhuar dhe mitiguar këto rreziqe, duke integruar dimensionin ESG në të gjitha kategoritë e rrezikut të bankës: kreditor, tregtar, operacional etj. Banka ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të përfshirjes së rrezikut ESG në procesin e kreditimit, duke synuar zgjerimin gradual të këtij procesi edhe në kategoritë e tjera të rrezikut, duke zgjeruar Kuadrin e Oreksit të Rrezikut (RAF), sipas një plani veprimi 1–3 vjeçar. Ky plan është bazuar në Udhëzuesin mbi Rreziqet Financiare të Lidhura me Klimën dhe Mjedisin, të miratuar nga autoriteti mbikëqyrës.

10. Politikat kontabël të Grupit Bankar²

a) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. Ato janë paraqitur në Lekë, e cila është edhe monedha funksionale, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt dhe janë përgatitur sipas parimit të kostos historike.

b) Baza e konsolidimit

Kombinimi i biznesit

Grupi njeh kombinimet e biznesit në datën kur kontrolli i është transferuar atij. Aksionet kontabilizohen në pasqyrat e veçanta me çmimin e blerjes, kur ky është vlera e drejtë, domethënë, me çmimin me të cilin ato u përfituan ose me vlerën e përcaktuar në kushtet e kontratës së përfitimit. Çdo fitim prej një blerje të volitshme njihet në fitim humbje menjëherë. Kostot e transaksionit njihen kur ndodhin. E drejta e transferuar nuk përfshin shumën të lidhura me zgjidhjen e marrëdhënieve që kanë ekzistuar më parë. Shuma të tilla janë përgjithësisht të njohura në fitim humbje. Pasqyrat e konsoliduara përgatiten në bazë të vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve të secilit Filial.

² Këto janë politikat kontabël sipas Bankës së Shqipërisë; politikat kontabël sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR), përfshirë edhe ato të vitit 2022, janë të publikuara një herë në vit se bashku me pasqyrat financiare të audituara në site të Bankës në seksionin 3. Politikat Kryesore Kontabël.

Filialet

“Filialet” janë njësi të kontrolluara nga Grupi. Ato përfaqësojnë pjesë pronësie në kapitalin e shoqërive në të cilat Grupi ka për qëllim t’i mbajë për një periudhë të gjatë kohe dhe të cilat gjykohen të dobishme për veprimtarinë e Grupit. Grupi “kontrollon” një investim nëse është i ekspozuar ndaj, apo ka të drejta mbi kthimin e ndryshueshëm nga përfshirja në investim dhe ka mundësinë për të ndikuar mbi këtë kthim nëpërmjet pushtetit të tij mbi investimin. Grupi rivlerëson nëse ka kontroll dhe nëse ka ndryshime në një apo më shumë elementë të kontrollit. Kjo përfshin rrethanat kur të drejtat mbrojtëse të mbajtura (psh. nga një marrëdhënie kredie) bëhen të rëndësishme dhe çojnë në kontroll mbi shoqërinë ku investohet. Në bazë të rregullores për “Mbikëqyrjen e konsoliduar” përjashtohen nga konsolidimi dhe paraqiten si “Filiale” (pika j më poshtë) të gjitha institucionet financiare totali i bilancit të të cilave nuk tejkalon 1% të bilancit të institucionit mbizotërues dhe investimet në subjekte të cilat nuk janë institucione financiare. Përveç sa më sipër, Pasqyrat financiare të Filialit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara duke filluar nga data në të cilën fillon kontrolli deri në datën kur ky i fundit përfundon.

Humbja e kontrollit

Kur Grupi humb kontrollin mbi Filialet e tij, ai çregjistron asetet dhe detyrimet e Filialeve. Ndonjë fitim ose humbje e rezultuar gjatë këtij procesi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur humbet kontrolli interesat e mbajtura në Filiale maten me vlerën e drejtë.

Eliminimi i transaksioneve gjatë konsolidimit

Pasqyrat financiare të konsoliduara ndërtohen sipas metodës së konsolidimit të plotë. Të gjitha llogaritë e mjeteve, detyrimeve dhe pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve të Filialeve konsolidohen me llogaritë e të njëjtës natyre të Mëmës. Balancat dhe transaksionet brenda Grupit, dhe ndonjë e ardhur apo shpenzim i përealizuar të linduara nga transaksionet brenda Grupit (përveç fitim humbjeve nga transaksionet e këmbimit), eliminohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Në të njëjtën linjë investimet e Mëmës në Filiale eliminohen me kapitalin aksionar të Filialeve. Humbjet e përealizuara eliminohen në të njëjtën mënyrë si fitimet e përealizuara, por vetëm kur nuk ka evidencë për zhvlerësim.

c) Veprimet në monedha të huaja

Veprimet në monedha të huaja janë këmbyer me kursin e këmbimit të ditës së kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj, të cilat janë regjistruar me koston historike në datën e transaksionit, janë këmbyer me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

Aktivitetet dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj, të cilat mbahen me kosto historike, janë këmbyer me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së veprimit.

Diferencat që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit që rezultojnë nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare janë njohur në pasqyrën e veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kapitali aksionar i kontribuar në monedhë të huaj trajtohet si një zë monetar dhe si i tillë konvertohet në Lekë duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Vetëm për qëllime prezantimi kapitali aksionar paraqitet në bilanc me vlerën në Lekë duke përdorur kursin historik, ndërsa diferenca mes kësaj vlerë dhe vlerës në Lekë duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit, paraqitet veçmas si “rezervë e rivlerësimit”.

d) Arka dhe llogari me Bankën Qendrore

Arka dhe llogari me Bankën Qendrore përbëhen nga gjendjet e parasë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me Bankën Qendrore, si dhe rezerva e detyrueshme me Bankën Qendrore.

e) Depozitat dhe llogaritë me bankat

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat ndërbankare me datë shlyerje dhe normë interesi të paracaktuar.

f) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme janë investime në obligacione të cilat janë përfituar që në fillim me synim për t’u rishitur në një periudhë afatshkurtër, deri në 6 muaj dhe kur: a) ato janë të negociueshme në një treg

dhe b) çmimet e tregut të letrave me vlerë në fjalë janë gjithë kohës të disponueshme për të tretët. Ato janë regjistruar me çmimin e përfitimit të tyre, përfshi shpenzimet dhe çdo interes të përlogaritur.

Në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrave financiare, ato vlerësohen me çmimin më të fundit të tregut. Shuma e përgjithshme e diferencave që rezulton nga ndryshimet e çmimit regjistrohet në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve.

Banka rishikon periodisht klasifikimin e letrave me vlerë të tregtueshme përfshi datën e hartimit të pasqyrave financiare. Në vijim të këtij rishikimi nëse ka ndryshime në klasifikim ose pasi ato janë mbajtur të paktën për 6 muaj, letrat me vlerë të poseduara duhet të zhvendosen nga letrat me vlerë të tregtueshme në letra me vlerë të vendosjes ose letra me vlerë të investimit.

g) Letra me vlerë të vendosjes

Letrat me vlerë të vendosjes janë investime në obligacione të cilat mbahen për një periudhe prej më shumë se 6 muaj, me përjashtim të atyre letrave me vlerë të cilat banka synon t'i posedojë deri në datën e maturimit dhe të cilat kënaqin rregullat që kanë të bëjnë me letrat me vlerë të investimit. Letrat me vlerë të vendosjes regjistrohen në datën e përfitimit me çmimin e tyre të përfitimit përjashtuar shpenzimet.

Në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrave, do të krijohen fonde rezervë, sipas grupeve homogjene të letrave me vlerë të njëjtit lloj, kundrejt humbjeve kapitale të porealizuara që rezultojnë nga diferenca midis vlerës kontabël dhe çmimit të tregut për letrat me vlerë. Fitimet kapitale të porealizuara nuk regjistrohen.

h) Investime në letra me vlerë të mbajtur deri në maturim

Investimet në letra me vlerë mbajtur deri në maturim konsistojnë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare, obligacione të qeverive të huaja dhe të korporatave të huaja si edhe obligacione të emetuara nga kompanitë e grupit; të blera me qëllimin e mbajtjes së tyre deri në maturim dhe për rrjedhojë klasifikohen si të tilla.

Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim regjistrohen në ditën e blerjes dhe fillimisht maten me kosto, përjashtoi shpenzimet. Nëse ato ishin regjistruar më parë si letra me vlerë të tregtueshme ose të vendosjes, atëherë ato do të regjistrohen me çmimin e tregut që mbizotëron ditën e transferimit.

Diferencat midis çmimit të përfitimit (kostos) apo çmimit të tregut në ditën e transferimit dhe vlerës nominale amortizohen gjatë periudhës.

Në datat raportuese letra me vlerë mbajtur deri në maturim maten me kosto të amortizuar, duke i zbritur fondin rezervë për mbulimin e humbjeve që krijohet për të mbuluar rrezikun e mospërmbushjes së detyrimit nga ana e emetuesit të letrave me vlerë.

i) Huatë dhe paradhëniet për klientët dhe institucionet financiare

Huatë dhe paradhëniet për klientët si edhe ato për institucionet financiare raportohen me vlerën e tyre neto të realizueshme me provigjionin e humbjeve specifike nga huatë. Huatë regjistrohen kur shuma totale është disbursuar dhe pagesat njihen kur paraja arkëtohet. Në rastin e Overdrafteve dhe paradhënieve të tjera, kur fondet nuk përdoren menjëherë, angazhimi kreditor pasqyrohet jashtë bilancit.

Kreditë janë klasifikuar në një nga pesë kategoritë e rrezikut: standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta, të humbura. Interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë. Interesat e llogaritur por që nuk u ka ardhur afati i pagimit ose që nuk janë paguar ende, kalohen në llogarinë e të ardhurave dhe njihen si aktiv në llogarinë "interesa të përlogaritur". Kur huatë klasifikohen si nënstandarde, të dyshimta ose të humbura, nuk llogaritet më interes.

Fondet rezervë për mbulim humbjesh janë krijuar në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë" (Rregullorja e Kredisë), miratuar me vendimin Nr. 62 me 14.09.2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014, ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015, ndryshuar me vendim nr. 50, datë 30.03.2016, ndryshuar me vendimin nr. 52, datë 03.07.2019, ndryshuar me vendimin qarkullues nr.13, datë 12.03.2020, ndryshuar me vendimin qarkullues nr.33 datë 28.05.2020 dhe me vendimin nr. 5, datë 13.01.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Rregullorja kërkon që Grupi të klasifikojë ekspozimet në kategori rreziqesh të mëposhtme. Për çdo kategori të rrezikut, aplikohen normat minimale të provigjionimit për fondeve rezervë si më poshtë:

Lloji i huasë	Norma e fondit rezerve për	
	Huatë dhe paradhëniet	Kontratat e qirasë financiare
Standarde	1%	1%
Në ndjekje	5%	5%
Nën standard	Jo më pak se 20%	Jo më pak se 20%
Të dyshimta	Jo më pak se 50%	Jo më pak se 20%
Të humbura	100%	Jo më pak se 20%

Për interesat e përllogaritur të huave nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura, krijohet fond rezervë në masën 100%.

Fondet rezervë kontabilizohen si zhvlerësim i mjeteve (në bilanc) kundrejt llogarisë së humbjes në pasqyrën e fitimeve dhe të humbjeve. Në rastet e shlyerjeve të kredisë apo fshirjeve nga bilanci të gjitha fondet rezervë të regjistruara për këto shuma stornohen.

Huatë mund të jenë objekt i një ristrukturimi. Kreditë e ristrukturuara nuk mund t'i nënshtrohen rregullave standarde të klasifikimit deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve: a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt këstet për një periudhë prej 12 muajsh nga data e ristrukturimit dhe këstet gjatë kësaj periudhe duhet të jenë materiale krahasuar me këstet e planit të pagesës të parashikuar për periudhën në vijim; b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 4 këste.

Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “standarde” ose “në ndjekje”, nëse ristrukturohet për herë të parë, pas ristrukturimit nuk mund të klasifikohet, në asnjë rast, më lart se kategoria “nënstandarde”, deri në plotësimin e kushteve të mësipërme. Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “nënstandarde”, “të dyshimta” ose “të humbura”, nëse ristrukturohet për herë të parë, pas ristrukturimit ruan të njëjtën klasë, deri në plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “standarde” ose “në ndjekje”, nëse ristrukturohet për herë të dytë, pas ristrukturimit nuk mund të klasifikohet, në asnjë rast, më lart se kategoria “e dyshimtë”, deri në plotësimin e kushteve të mësipërme. Kredia, e cila para ristrukturimit klasifikohet në kategoritë “nënstandarde”, “të dyshimta” ose “të humbura”, nëse ristrukturohet për herë të dytë, pas ristrukturimit klasifikohet në një klasë më të ulët nga kategoria në të cilën ishte klasifikuar përpara ristrukturimit, deri në plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kredia, e cila është ristrukturuar për më shumë se dy herë, pas ristrukturimit klasifikohet, në kategorinë “të humbura”, deri në plotësimin e kushteve të mësipërme.

Huatë për klientët raportohen neto, pas zbritjes së fondeve rezervë për huatë që klasifikohen si nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Fondet e krijuara për humbjet e mundshme nga huatë që klasifikohen si standarde dhe në ndjekje, regjistrohen si provigjion statistikor në anën e detyrimeve të bilancit kontabël nën kategorinë “Detyrime të tjera”.

Ndërsa huatë për institucionet financiare raportohen neto, pas zbritjes së fondeve rezervë për huatë që klasifikohen si në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Fondet e krijuara për humbjet e mundshme nga huatë që klasifikohen si standarde, regjistrohen si provigjion statistikor në “Detyrime të tjera”.

j) Investime në Filiale

Investime në Filiale paraqet investimet në UFC, UFS, UUK, Paylink sha dhe Auto City sha; të cilat janë matur fillimisht me kosto. Në cdo datë raportuese të mëpasshme, përcaktohet vlera reale e aksioneve, dhe nëse parashikohet që vlera reale do të mbetet më e ulët se sa vlera kontabël neto për një periudhë afatgjatë regjistrohet fondi rezervë për amortizim.

Dividentët kontabilizohen si e ardhur dhe regjistrohen në datën që ato shpallen zyrtarisht nga organizmat ligjorë të Filialit (Mbledhja e aksionarëve).

k) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara

Aktivitet e qëndrueshme të trupezuara maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, në qoftë se ka. Kosto përfishin shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitet. Programet kompjuterike që janë pjesë e funksionimit të pajisjes në të cilën ato janë instaluar, kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje. Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare mbi jetën e parashikuar të përdorimit të aktiveve. Aktivitet e qëndrueshme në proces nuk amortizohen.

Të ardhurat apo humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivitet të trupëzuar (llogaritur si diferencë midis arketimeve nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vleres kontabel te aktivitet) njihen si të ardhura të tjera në pasqyren e fitim humbjeve.

Aktivitet e patrupëzuara të blera nga Banka maten me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar, i cili llogaritet sipas metodës lineare, dhe zhvleresimin kur është i aplikueshëm. Amortizimi njihet në fitim humbje sipas metodës lineare, duke u nisur nga data në të cilën është i vlefshëm për punë.

Amortizimi dhe zhvlerësimi i vitit është llogaritur në përputhje me normat e mëposhtme:

Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%
Aktive të tjera të trupëzuara	20%
Aktive të patrupëzuara (programe kompjuterike, shpenzime të nisjes dhe të tjera)	20%

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike që i atribuohen atyre do të rrjedhin te Banka në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes regjistrohen në shpenzimet kur ndodhin.

l) Përmirësime të aktiveve të marra me qira

Përmirësime të aktiveve të marra me qira perfaqësojnë “shpenzime për t’u amortizuar në disa vite”, sepse përdorimi i tyre shtrihet në më shumë se një periudhë kontabël. Afati i përdorimit të këtyre përmirësimeve varion nga 3 në 15 vjet. Këto shpenzime shpërndahen përgjate periudhës së qirasë.

m) Aktive të trupëzuara të marra nëpërmjet një procesi ligjor

Aktive të trupezuara të marra nëpërmjet një procesi ligjor, janë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të përfituara kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna nga Grupi klientëve. Vlera kontabël e këtyre aktiveve pritet të rikuperohet nëpërmjet shitjes së tyre. Këto aktive regjistrohen në datën e regjistrimit në hipotekë në emër të Grupit dhe regjistrohen me vlerën e ankandit më të fundit në të cilin Grupi ka pranuar marrjen në pronësi të tij.

Në rastet kur këto aktive nuk mund të shiten brenda vitit të parë të përfitimit të tyre, Grupi krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre.

Fondet rezervë për mbulim humbjesh nga zhvlerësimi i këtyre aktiveve gjatë vitit 2024, janë krijuar në përputhje me rregulloren “Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë” (Rregullorja e Kredisë), miratuar me vendimin Nr. 62 me 14.09. 2011, ndryshuar me vendimin nr. 27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014, ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015, ndryshuar me vendim nr. 50, datë 30.03.2016, ndryshuar me vendimin nr. 52, datë 03.07.2019, ndryshuar me vendimin qarkullues nr.13, datë 12.03.2020, ndryshuar me vendimin qarkullues nr. 33 datë 28.05.2020 dhe me vendimin nr. 5, datë 13.01.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Rregullorja në fjalë kërkon që Banka të krijojë fonde si më poshtë:

Viti i marrjes në pronësi	Norma e Fondit
Viti i parë	5%
Viti i dytë	15%
Viti i tretë	30%
Viti i katërt	45%
Viti i pestë	60%
Viti i gjashtë	80%
Viti i shtatë	100%

n) Marrëveshjet e riblerjes

Marrëveshjet e riblerjes janë marrëveshje në të cilat Banka shet një aktiv financiar (letër me vlerë) dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo). Ky transaksion nuk konsiderohet si një nxjerrje e aktivitet jashtë përdorimit dhe Banka ruan të gjitha përfitimet që lindin nga zotërimi i aktivitet financiar (letrës me vlerë). Në përmbajtje kjo marrëveshje është një hua dhe për rrjedhojë kontabilizohet si një detyrim financiar, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

o) Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse janë burimet kryesore të Bankës për financim. Depozitat me afat përfaqësojnë shumat e depozituara nga klientët, dhe mbartin një datë shlyerjeje dhe një normë interesi të pranuar. Ato kontabilizohen në datën fillestare të tyre si detyrim. Në datën e maturimit depozitat shlyhen ose rinovohen për një periudhë tjetër të pranuar. Interesat kontabilizohen pjesë pjesë sipas fluksit në kohë dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe njihen si detyrim deri në momentin e pagesës.

p) Borxhi i varur

Paraqet huamarrje të Grupit të cilat, në rast likuidimi janë të dorës së dytë kundrejt shlyerjes së kreditorëve të tjerë. Vlera e borxhit dhe interesi i përlllogaritur regjistrohen si detyrime. Cdo shpenzim lidhur me emetimin e borxhit është regjistruar si shpenzim i periudhës.

q) Provigjonet

Provigjoni njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin.

r) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen sipas parimit të të drejtave të konstatuara. Regjistrimi i tyre bëhet në bazë rrjedhëse (duke u bazuar tek përlllogaritja), pra paraqiten kur ato fitohen ose shkaktohen.

s) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet rrjedhin nga shërbimet financiare të ofruara nga Grupi si transferimi i fondeve, aktivitete huadhënëse, tarifat e marra për krijimin e huave dhe paradhënieve të klientëve, tarifat e mirëmbajtjes së llogarive, komisione të garancive bankare, etj. Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet njihen kur shërbimet përkatëse janë kryer.

t) Të ardhurat dhe Shpenzimet për qira

Të ardhurat e marra dhe shpenzimet bëra për qiratë operationale njihen në pasqyrën e fitim humbjeve sipas metodës lineare përgjatë jetës së qirase. Zbritjet e bëra apo të marra nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të të ardhurave e shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

u) Aktivitetet e dhëna me qira financiare – qiradhënësi

Në rast se Grupi është qiradhënësi në një kontratë të qirasë që transferon në mënyrë substanciale të gjithë rrezikun dhe përfitimet e aktivitet tek qiramarrësi, atëherë marrëveshja klasifikohet si qira financiare dhe paraqitet në hua dhe paradhënie për klientët.

v) Tatimi

Grupi e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor Shqiptar. Tatim fitimi i pagueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin statutor përpara taksave për disa zëra të caktuar të të ardhurave dhe të shpenzimeve siç kërkohet nga Legjislacioni Shqiptar. Fitimi statutor bazohet në regjistrimet kontabël të mbajtura nga Grupi për qëllime të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) dhe mund të ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga raportimi i pozicionit financiar për qëllime rregullatore në përputhje me MRF.

w) Përfitimet e punonjësve

Grupi paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar. Kontributet e Grupit ndaj planit të pensionit njihen si shpenzim në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

x) Veprimet spot të këmbimit valutor

Grupi gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm hyn në këmbime valutore spot me data likuidimi dy ditë pas datës së veprimit. Këto veprime regjistrohen si zëra jashtë bilancit në datën e transaksionit dhe regjistrohen në pasqyrat financiare në datën e likuidimit. Efekti i rivlerësimit i balancave të zërave jashtë bilancit njihet dhe regjistrohet në datën e veprimit.

y) Përdorimi i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me MRF kërkon që menaxhimi të bëjë vlerësime dhe parashikime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, në informacionin shpjegues për aktivet dhe detyrimet e mundshme ekzistuese në datën e pasqyrave financiare dhe në shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit të raportimit. Kur bëhen vlerësimet e nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, Grupi mban gjithmonë pozicionin më konservator për të shmangur rrezikun që mjetet ose të ardhurat të vlerësohen më tepër dhe detyrimet ose shpenzimet më pak. Pasqyrimi kontabël i mjeteve dhe detyrimeve bëhet në përputhje me përmbajtjen dhe realitetin ekonomik të tyre dhe jo vetëm me paraqitjen ligjore të tyre. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

z) Informacioni krahasues

Informacioni krahasues është paraqitur vazhdimisht në përputhje me politikat e kontabilitetit të Grupit.

aa) Ndreqja e gabimeve

Gabimet mund të ndodhin nga zbatimi jo si duhet i metodave kontabël. Ndreqja e gabimeve kontabilizohet në pasqyrën e të ardhurave sipas natyrës së veprimit të korrektuar.

Gabimet është e domosdoshme të ndreqen gjatë vitit financiar gjatë të cilit u zbuluan (dhe jo në vitin financiar gjatë të cilit u bënë).

11. Politikat e Shpërblimit

Drejtorët e Departamenteve dhe menaxherët e institucioneve financiare pjesë të Grupit do të trajtojnë çështjet e stafit në punën e përditshme, duke pasur gjithnjë parasysh rëndësinë e tyre themelore për suksesin e çdo punonjësi, brenda kufijve të interesit të institucionit përkatës. Me përjashtim të çështjeve të BNJ të lidhura me pozicione menaxheriale, në të cilat një pjesë e përgjegjësive i takon Këshillave Drejtues të institucioneve të Grupit, të gjitha çështjet e BNJ do të kanalizohen nëpërmjet Departamenteve të BNJ, pa i anashkaluar ato në asnjë proces të lidhur me stafin. Kjo konsiderohet e rëndësishme për të arritur paanshmëri dhe për të rritur rëndësinë e burimeve njerëzore në kompanitë e Grupit. Departamentet e BNJ pritet jo vetëm të ekzekutojnë të gjitha aktivitetet e burimeve njerëzore, por edhe të ndërmarrin nisma për përmirësimin e BNJ në çdo institucion të Grupit.

Departamentet BNJ janë nën vartësinë direkte të Drejtorëve të Përgjithshëm Ekzekutive/ Administratoreve të institucioneve, të cilët janë përgjegjës për çështjet e burimeve njerëzore në institucionet/kompanitë e tyre. Çështjet e burimeve njerëzore adresohen edhe nëpërmjet Komiteteve të BNJ (aty ku ato janë të ndërtuara).

10.1 Pagat

Qëllimi i institucioneve të Grupit është të kenë një program shpërblimi në linjë me kushtet e biznesit, ndryshimet në tregun e punës dhe vlerat e Grupit. Shpërblimi shërben si një pjesë e një pakete që përfshin pagën, bonuse dhe përfitime për punonjësit. Si rregull i përgjithshëm, vendimet për shpërblim sipas performancës bazohen në:

- performancën e përgjithshme të çdo institucioni të Grupit;
- performancën e njësisë së biznesit nisur nga realizimi i objektivave të biznesit;

- performancën individuale nisur nga niveli i arritjes së objektivave individuale dhe cilësitë dhe aftësitë, sipas vlerësimit të performancës.

Paga individuale bazohet në strukturën e pagave të çdo institucioni, që përmban rangje me minimumin dhe maksimumin e pagës për secilin apo për një grup pozicionesh, bazuar në hierarkinë ose vlerësimin e pozicionit.

Institucionet e Grupit ndërmarrin rishikime të pagave bazuar në rregullat e mëposhtme:

Rritja fillestare: Si rregull, punonjësit e rinj në nivel “junior” fillojnë në një nivel më të ulët se paga bazë e pozicionit. Rishikimi fillestar bëhet pas një periudhë 3-6 mujore, bazuar në një vlerësim me shkrim të performancës dhe propozim nga drejtuesi. Nëse vlerësimi i performancës është pozitiv, atëherë ai kalon në nivelin minimal të pagës së pozicionit.

Rritja për promovim: Kur një punonjës promovohet dhe i ngarkohen përgjegjësi të reja pune, punonjësi konsiderohet për rritje për efekt promovimi. Punonjësi merr rritje page që i korrespondon pozicionit të ri dhe njohurive dhe eksperiencës që lidhen me pozicionin.

Rritja për performancë: Çdo punonjës konsiderohet çdo vit për rritje (ose ulje) të pagës në bazë të performancës. Rishikimi nuk garanton rritjen. Rritjet për performancë përfitohen nga një performancë që tejkalon kërkesat e punës. Rritja për performancë do të kryhet pas mbylljes së pasqyrave financiare të vitit paraardhës.

Rritja për besnikëri: (aplikohet nga Banka). Çdo punonjës që ka performuar mirë, ka arritur objektivat, por nuk i ka kaluar ato nëse nuk ka pasur rritje page për vitin paraardhës, do të përfitojë rritje page në vitin korent, deri në nivelin maksimal të rangut të pagës për pozicionin përkatës. Përqindja e rritjes do të vendoset nga Këshilli Drejtues.

10.2 Përfitimet

Çdo institucion i Grupit angazhohet të sigurojë një skemë të plotë përfitimesh për punonjësit e tij, në mënyrë që të tërheqë dhe mbajë staf të aftë. Grupi do të ofrojë përfitimet e përcaktuara në Kodin e Punës.

Për më tepër, Grupi mund të ofrojë:

- (disa prej) produkteve dhe shërbimeve të tij për punonjësit, me kushte preferenciale;
- sigurim shëndetësor.

Çështjet ligjore, të taksave dhe kostot, do të merren në konsideratën e duhur.

10.3 Shpërblimet

Shpërblimi variabël i njihet dhe shpërblen punonjësit për performancë, për tejkalimin e objektivave vjetore, për përpjekje të jashtëzakonshme dhe për rezultate pozitive biznesi. Shpërblimet nuk jepen automatikisht çdo vit dhe vendosen ekskluzivisht nga menaxhimi dhe Këshilli Drejtues i çdo institucioni të Grupit.

Këshillet Drejtuese mund të aprovojnë çdo vit shpërblimet e mëposhtme:

- *Shpërblimi i Viti të Ri*, si rregull në % ose në një vlerë të caktuar të lidhur me pagën bazë, me një limit maksimal gjithësesi.
- *Shpërblimi vjetor i lidhur me performancën*, në % ndaj pagës bazë, në varësi të realizimit të objektivave të biznesit në nivel dege/departamenti.

Shpërblimet e mëposhtme aplikohen nga menaxhimi për stafin e Bankës:

- *Shpërblimet tremujore për shitjet* – ky shpërblim aplikohet vetëm nga Banka, e cila ka vendosur një sistem shpërblimi tremujor për degët dhe punonjësit më të suksesshëm, të mbështetur në suksesin në shitje të bankës, cilësinë e shërbimit dhe performancën e përgjithshme të degës. Këto shpërblime do të jepen nën rregulla dhe me vendime diskrecionare të menaxhimit të Bankës.
- *Shpërblimi për performancë të jashtëzakonshme* ose realizimin e një projekti, aprovohet rast pas rasti.

10.4 Shpërblimet e Këshillave Drejtues dhe Drejtimit Ekzekutiv

Anëtarët e Këshillave Drejtues paguhen me një shumë fikse vjetore për ushtrimin e funksionit si anëtarë të Këshillit dhe një tarifë për ushtrimin e funksionit gjatë mbajtjes së mbledhjes së Këshillit Drejtues, paguar këto në baza tremujore.

Shpërblimi për Drejtimin Ekzekutiv përbëhet nga komponenti fiks dhe variabël që do të varen nga situata financiare e secilit institucion të Grupit.

10.5 Vlerësimi i Performancës

Vlerësimet e performancës bëhen me qëllim për të vlerësuar performancën e punonjësve, dhe për të siguruar një mundësi që punonjësi dhe eprori të diskutojnë përgjegjësitë e punës dhe të vendosin objektivat për të ardhmen.

Punonjësit do të vlerësohen në përfundim të tre muajve të parë të punësimit. Më pas, do të ketë minimalisht një vlerësim vjetor të stafit.

Shënim: Raporti Periodik i publikuar i Bankës i trajton më në detaje politikat e saj të shpërblimit.